

Dr. Musli Vërbani

PËRFITO DHE MËSO NGA HUTBET E SURES JUSUF

Kaçanik, 2026

Titulli:

Përfito dhe mëso nga hutbet e sures Jusuf

Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektor:

Burim Bunjaku

Përgatitja kompjuterike:

Ridvan Vërbani

HUTBEJA E PARË

TREGIMET E KUR'ANIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përshëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë:

نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ وَإِنْ كُنْتَ مِنْ قَبْلِهِ لَمِنَ الْغَافِلِينَ



“Ne, duke e shpallur këtë Kur'an, po të rrëfejmë ty (Muhamed) më të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”. (Jusuf, 3)

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin:

لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةً لِّأُولِي الْأَلْبَابِ ۚ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِن تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّلْقَوْمِ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١١١﴾

"Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson." (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Shokët e Muhamedit a.s. janë tubuar në një tubim dhe i kanë thënë: "O i dërguar i Allahut, sikur të na thoshe një tregim", atëherë ka zbritur ajeti:

"Ne, duke e shpallur këtë Kur'an, po të rrëfejmë ty (Muhamed) më të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit". (Jusuf, 3)

Pastaj është tubuar një turmë tjetër dhe kanë thënë: "O i dërguar i Allahut, sikur të na tregoje një tregim", atëherë ka zbritur ajeti:

اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُّتَشَابِهًا مَّثَانِي تَقْشَعِرُّ مِنْهُ جُلُودُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ ۚ ذَٰلِكَ هُدًى لِّلَّهِ يَهْدِي بِهِ مَن يَشَاءُ ۚ وَمَن يُضْلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِن هَادٍ ﴿٢٣﴾

"Allahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas herë (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurat dhe zemrat e tyre. Ky (libër) është udhëzim i Allahut, me të udhëzon atë që do. E atë që Allahu e le të humbur, për të nuk ka ndonjë udhëzues". (Ez-Zumer, 23)

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿لَقَدْ كَانَ فِي يُوسُفَ وَإِخْوَتِهِ آيَاتٍ لِّلْمُتَلَلِّينَ﴾ ﴿٧﴾

"Njëmend, për ata që pyesin (interesohen) në ndodhinë e Jusufit dhe të vëllezërve të tij, pati fakte (mbi fuqinë e Zotit)." (Jusuf: 7)

Sot do të flas për një tregim kur'anor.

Do të tregoj një histori për një personalitet fisnik e të ndershëm.

Tregim për një peygamber prej peygamberëve.

Për një personalitet i cili është ballafaquar me vështirësi.

Për një njeri i cili është ballafaquar me probleme e sprova të cilat sqarohen në suren Jusuf për peygamberin Jusuf a.s.

Pa dyshim se është tregimi më i bukur, më i miri dhe më mbresëlënësi.

Tregim me ndjenja, me ngjarje, me reflektime.

Tregim për rotacionin e jetës:

- Nga bashkimi në ndarje
- Nga ndarja në bashkim
- Nga dashuria në sprova
- Nga sprova në sprovë
- Nga një sprovë në një sprovë tjetër
- Nga burgu në udhëheqës
- Nga pikëllimi në gëzim
- Nga gjendja e vështirë në gjendje të mirë
- Nga kriza në fitore

Dhe shumë e shumë ngjarje të cilat janë impresionuese.

Për këtë arsye edhe është quajtur tregimi më i bukur dhe më i miri.

Vëllezër të nderuar!

Në historinë e Jusufit a.s.: Të gjitha personazhet përfundojnë mirë:

- Gruaja e Azizit dhe gratë u penduan
- I burgosuri me Jusufin u lirua nga burgu dhe filloi të punojë punën e mëparshme

- Mbreti e mbajti fronin dhe e shpëtoi popullin nga kriza ekonomike

- Vëllezërit u penduan dhe u bë bashkimi familjar

- Jusufi doli të jetë i suksesshëm në të gjitha sprovat

Tregimi flet për suksesin pas sprovave. Zoti i Madhërishëm thotë:

فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ﴿٥﴾

إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا ﴿٦﴾

“Pas çdo vështirësie ka lehtësim. Pas çdo vështirësie ka lehtësim”
(Inshirah, 5-6).

Sprovat e Jusufit a.s. janë të shumta, e prej tyre:

- Sprova e parë është urrejtja dhe xhelozia.

Pastaj,

- ndarja nga familja.

Pastaj,

- hedhja në pus.

Pastaj,

- edhe pse ishte i ndershëm, është shitur si skllav.

Pastaj,

- edhe pse ishte i ndershëm, i drejtë dhe i pafajshëm, është futë në burg.

Historinë e Jusufit do ta tregojmë në disa hutbe. Zoti i Madhërishëm thotë:

إِذْ قَالَ يُوسُفُ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ إِنِّي رَأَيْتُ أَحَدَ عَشَرَ كَوْكَبًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ رَأَيْتُهُمْ لِي سَاجِدِينَ ﴿٤﴾

"(Përkujto) Kur Jusufi, babait të vet i tha: 'O baba im, pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin dhe hënën, i pashë duke më bërë mua sexhde!'" (Jusuf, 4)

Tregimi i Jusufit quhet tregimi më i bukur edhe për faktin se:

Çdonjërit të cilit i tregohet, i kthehet shpresa dhe lumturia.

Kjo kuptohet nga situatat e:

- Jusufit me babanë e tij,
- Jusufit me vëllezërit e tij,
- Jusufit me gruan e mbretit,
- Jusufit me mbretin të cilit i shërben dhe ia interpreton ëndrrat.

Vëllezër të nderuar!

Kjo sure specifikohet me atë se lajmet e saj nuk përsëriten në suret tjera.

Në të përmenden shumë çështje të dobishme, të cilat janë të nevojshme për këtë botë dhe për botën tjetër, si p.sh.:

- Monoteizmi,
- Fikhu,
- Historia,
- Politika,
- Ekonomia,
- Familja,
- Interpretimi i ëndrrave dhe
- Planifikimi i jetës.

Allahu i Madhërishëm e ka zbritur këtë Kur'an me më së shumti kuptime të cilat i nevojiten njeriut, ashtu që:

- të mësoni atë që nuk keni mësuar nga tregimet dhe lajmet,
 - të mësoni nga edukata dhe morali,
 - të mësoni nga ligjet dhe dispozitat ligjore,
 - të mësoni nga programet politike,
 - të mësoni nga programet ekonomike,
 - të mësoni programet shoqërore,
 - të mësoni që të meditonin, të analizoni dhe të studioni kuptimet dhe qëllimet në të,
 - të mësoni çështjet të cilat ndërtojnë individin dhe shoqërinë.
- Historia e Jusufit është e kompletuar, sqaron çdo gjë.

Vëllezër të nderuar!

Tregimi i Jusufit është tregim i plotë dhe komplet, i sqaron në tërësi me qëllime specifike.

Tregimi i Jusufit është tregim gjithëpërfshirës, përmban çështjet e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Tregimi i Jusufit është tregim i cili:

- Tregon për çështjet shoqërore,
- Tregon për çështjet ekonomike,
- Tregon për çështjet politike,
- Tregon për çështjet edukative,
- Tregon për çështjet sociale.

Në tregimin e Jusufit kemi mësimë dhe këshilla:

- për popujt,
- për prindërit dhe
- për fëmijët.

Në tregimin e Jusufit me vëllezërit e tij dhe me babanë e tij ka mësimë dhe këshilla për pyetësit dhe për ata që kanë kërkuar atë.

Në tregimin e Jusufit me vëllezërit e tij tregon fuqinë e Allahut të Madhërishëm dhe për urtësinë e Tij për çdo gjë:

- tregon për vërtetësinë e peygamberisë së Jusufit dhe të tjerëve,
- sqaron përfundimin e të padrejtëve ndaj tij dhe
- sqaron vërtetësinë e ëndrrave të tij dhe interpretimeve të drejta të tij.

Kjo është histori impresionuese, ia vlen që të tregohet për të.

Përfundim

Tregimi i Jusufit është i përmbushur me mësimë dhe me këshilla.

Prej mësimëve, më i rëndësishmi është:

- Durimi nga tortura dhe
- falja kur ekziston mundësia e hakmarrjes.

Tri sprovat e Jusufit janë shndërruar në begati:

Sprova e parë: Kurthi i vëllezërve është shndërruar në begatinë e parë: dalja nga burgu.

Sprova e dytë: Joshja nga bashkëshortja e ministrit është shndërruar në begatinë e dytë: rritja e pushtetit.

Sprova e tretë: Burgosja është shndërruar në begatinë e tretë: bashkimi i Jusufit a.s. me prindërit dhe vëllezërit.

Pasi iu frikësua Allahut të Madhëruar dhe duroi, sprovat iu shndërruan në begati.

Historitë kur'anore janë mësimë, këshilla dhe përfitime.

Historia e Jusufit a.s. përmban një grumbull parimesh:

- Parimet e besimit,
- Parimet morale dhe
- Parimet fetare.

Ekziston lidhje e ngushtë në mes të mesazhit të Jusufit dhe mesazhit të Muhamedit a.s., baza e së cilës është falënderimi i begative ndaj Krijuesit të qiejve dhe të tokës, ndërsa kulmi i së cilës është besimi ndaj të padukshmes.

Në të shihen argumente për vërtetimin e ekzistimit të Allahut të Madhërishëm, Njëshmërisë së Tij.

Surja përqendrohet mbi bazën e meditimit, studimit në argumentet e gjithësisë.

Përmban cilësimet e njerëzve pas përmbajtjes së besimit.

Përmban kërcënimin e ndëshkimit pas Ditës së Gjykimit, gjë që e bën se ftesa e vulës së pejgamberëve bazohet në vlerat e moralit, në logjikën e shëndoshë. Të gjitha këto do t'i mësojmë në hutbet në vazhdim.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe të tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim si muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E DYTË

ËNDRRA E JUSUFIT A.S.

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Ne, duke e shpallur këtë Kur'an, po të rrëfejmë ty (Muhamed) më të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”. (Jusuf, 3)

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin:

“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Do të flas për ëndrrat në përgjithësi dhe për ëndrrën e parë të Jusufit në veçanti.

Disa ëndrra janë nga mendimet e njeriut, madje shumica e ëndrrave të njerëzve janë vetëm dukuri të bindjeve të tyre të praktikuara apo të papraktikuara.

Ëndrrat janë tri llojesh:

- Ëndrra të vërteta prej Allahut të Madhëruar,
- Ëndrra prej Shejtanit dhe
- Ëndrra nga mendimet e njeriut.

Ëndrrat e vërteta ndahen në disa nënloje:

Ato mund të jenë frymëzim të cilin Allahu i Madhëruar e hedh në zemrën e njeriut, që përbën të folurit e Zotit me robin e Tij në ëndërr.

Ato mund të jenë nga melekët e caktuar për këtë punë.

Ëndrra mund të jetë takim ndërmjet shpirtit të atij që është në gjumë me shpirtrat e të vdekurve të familjes, të farefisit, të shokëve të tij apo të dikujt tjetër, sikurse përmendëm deri tani.

Ndodh edhe hyrja e shpirtit të tij në Xhenet dhe shikimi i tij, etj.

Takimi i shpirtrave të të gjallëve me shpirtrat e të vdekurve është një nënloj i ëndrrave të sakta, të cilat te njerëzit janë një lloj i gjërave të ndjeshme.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kushdo që më sheh mua në ëndërr, sigurisht që ka parë të vërtetën, sepse shejtani nuk mund të marrë e të shfaqet në pamjen time.”

I dërguari i Allahut a.s. ka thënë:

“Një ëndërr e mirë e një besimtari të drejtë është një nga dyzet e gjashtë pjesët e pejgamberisë.”

Është dëgjuar Pejgamberi a.s. duke thënë:

“Prej pejgamberisë nuk ka mbetur më gjë tjetër, përveç paralajmeve të mira”.

E pyetën: “Ç’janë paralajmet e mira?”

Ai u përgjigj: “Ëndrrat e mira e të vërteta që përcjellin lajme të mira”.

Vëllezër të nderuar!

Ndonjëherë ëndrra mund të jetë ëndërr shpirtërore dhe shumë impresionuese, e cila është e pakrahasueshme me ndonjë shembull të librave, dhe është e vështirë për ta pasqyruar pas zgjimit nga gjumi dhe për të qenë e realizueshme:

Ekzistojnë ëndrrat të cilat në mënyrë kategorike tregojnë se çka do të ndodhë,

Ekzistojnë ëndrrat të cilat në mënyrë kategorike pasqyrojnë fatkeqësitë në të ardhmen,

Ekzistojnë ëndrrat të cilat në mënyrë kategorike mahnisin edhe ëndërruesin e asaj ëndrre, edhe dëgjuesin e asaj ëndrre,

Ekzistojnë ëndrrat për të cilat ka droje ai ëndërrues, pasi ëndërron diçka të cilën as nuk mund ta imagjinojnë mendjet e njerëzve apo logjika shkencore, sepse ëndrra nuk i nënshtrohet kandarit praktik apo çështjes së dukshme.

Vëllezër të nderuar!

Prej ëndrrave impresionuese është ëndrra e Jusufit a.s.

Jusufi a.s. ishte në moshën e vegjëlisë, pra, para pejgamberisë.

Në natën e Kadrit, e cila korrespondonte edhe me natën e ditës së xhuma, Jusufi kishte parë një ëndërr impresionuese dhe ia tregoi atë babait.

Zoti i Madhërishëm i thotë Muhamedit a.s.: Përkujtoja popullit tënd tregimin e Jusufit kur i ka thënë babait të vet, Jakubit a.s.: “Unë kam parë në ëndrrën time njëmbëdhjetë trupa qiellore, apo yje, po ashtu edhe diellin dhe hënën duke më bërë mua sexhde, sexhde respekti dhe nderimi, e jo sexhde adhurimi dhe madhështimi”.

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِذْ قَالَ يُوسُفُ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ إِنِّي رَأَيْتُ أَحَدَ عَشَرَ كَوْكَبًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ رَأَيْتُهُمْ لِي سَاجِدِينَ ﴿٤﴾

“(Përkujto) Kur Jusufi, babait të vet i tha: ‘O baba im, pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin dhe hënën, i pashë duke më bërë mua sexhde!’” (Jusuf: 4)

Mirë është që djali t’ia tregojë vështirësitë babait.

Mirë është që djali t’ia tregojë gjendjen babait.

Mirë është që djali t’ia tregojë planet e jetës babait.

Mirë është që djali t’ia tregojë ardhmërinë babait.

Komunikimi në mes babait dhe djalit duhet të jetë i vazhdueshëm gjatë gjithë jetës. Ky komunikim duhet të jetë komunikim parlamentar.

Kështu ka vepruar Jusufi a.s. me babanë e tij. Nuk ia ka treguar askujt tjetër përpos babait të tij.

Nuk ia ka treguar të tjerëve pa ia treguar babait të tij. Kjo është edukata e fëmijës me prindin.

Kështu pra, konsultohu me prindin, bisedo me prindin, hapja zemrën prindit.

Njerëzit e mirë gëzohen kur ti arrin sukses.

Njerëzit e mirë gëzohen kur ke ndonjë plan të mirë. E, kush gëzohet më shumë se prindi yt!

Njerëzit jo të mirë xhelozojnë kur arrin ndonjë sukses.

Edhe kur ke ndonjë plan të mirë i cili do të rezultojë i suksesshëm, mos ia trego çdokujt.

Planet e tua mos ia trego çdokujt.

Suksesin tënd mos ia trego çdokujt.

Çështjet e tua mos ia trego çdokujt.

Gjendjen tënde mos ia trego çdokujt.

Zgjidhe personin të cilit duhet t'ia tregosh sukseset.

Mos u bën injorant.

Mos u bën naiv, ngase:

Naivi i beson çdokujt,

Flet pa vend,

Hidhërohet pa arsye,

Ia shpalos sekretet çdokujt,

Nuk e dallon mikun prej armikut.

Vëllezër të nderuar!

Çka i ka thënë babai djalit?

Babai i thotë birit të tij: Mos ua trego vëllezërve të tu atë që ke parë në ëndërr.

Mos ua trego, se mos po të xhelozojnë, e që më pas të përgatitin ndonjë kurth për të të mashtruar dhe mund të të ndodhë diçka e padëshiruar, sepse shejtani është armik i qartë i njeriut.

Jakubi u frikësua se vëllezërit do ta xhelozonin, nga se shejtani ndërhynte.

Kjo është metodologji e edukimit.

Jakubi a.s., kur e ndaloi, e tregoi edhe arsyen:

قَالَ يَا بُنَيَّ لَا تَقْصُصْ رُؤْيَاكَ عَلَى إِخْوَتِكَ فَيَكِيدُوا لَكَ كَيْدًا ۚ إِنَّ الشَّيْطَانَ لِلْإِنْسَانِ عَدُوٌّ مُبِينٌ



“O biri im, mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve tu, se po të bëjnë ndonjë dredhi; s’ka dyshim, djalli për njeriun është armik i hapët”.

(Jusuf, 5)

Në anën tjetër, babai duhet t’ia tregojë zgjidhjen e problemit.

Disa djem dhe vajza frikësohen t’i tregojnë prindit për ngjarje nga frika se i dënon, andaj shkojnë te ndonjë shok apo i huaj dhe ia tregojnë problemin për t’ia zgjidhur.

Edhe pse ëndrra ka qenë e mirë, babai e mëson që të mos ua tregojë vëllezërve të tij, më të afërmeve.

Kjo këshillë ka qenë për të mirën e djalit, për të mirën e Jusufit.

Në disa raste fëmijët nuk mund t’i kuptojnë këshillat e prindit.

Jakubi i ka thënë të mos ua tregojë ëndrrën vëllezërve të Jusufit nga frika se mos do ta urrenin, nga brenga se mos do ta xhelozonin.

Pse Jakubi a.s. i ka thënë të mos ia tregojë ëndrrën vëllezërve?

Nga shkak se Jakubi i ka njohur bijtë e vet.

Vëllezërit e Jusufit nuk kanë qenë pejgamberë, pasi kanë pasur cilësi të cilat nuk përputhen me sigurinë e pejgamberëve, si p.sh.:

- xhelozia e kësaj bote,
- mosdëgjimi ndaj prindërve,
- nënshtrimi ndaj shkaqeve të shkatërrimit dhe vrasjes.

Ky ka qenë shkak që Jakubi a.s. t'i thotë: **“Ëndrrën tënde mos ia trego vëllezërve tu”**.

Duke pasur parasysh se ëndrra ishte tepër interesante, ka pasur nevojë për një kohë të gjatë deri te realizimi i saj në praktikë, e ajo kohë ka qenë pas dyzet vitesh ose edhe më shumë. Realizimi i ëndrrës nuk bëhet menjëherë pas një dite apo pas një jave, edhe pse mund të ndodhë ndonjëherë.

Vëlla i nderuar!

Mos ia trego hallin çdokujt.

Planet për të ardhmen mos ia trego çdokujt, bile edhe më të afërmve.

Gjendjen tënde të mirë apo të lumtur mos ia trego çdokujt.

Gjendjen tënde të rëndë apo të keqe mos ia trego çdokujt.

Njerëzit e këqij hidhërohen dhe xhelozojnë kur të ndodhë ndonjë e mirë.

Andaj sukseset mos ia trego çdokujt, punën e mirë mos ia trego çdokujt.

Programin tënd mos ia trego çdokujt.

Njerëzit e këqij xhelozojnë kur të ndodhë ndonjë e mirë.

Njerëzit e mirë kënaqen kur ndodhë ndonjë e mirë.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Në qoftë se dikush sheh një ëndërr që e pëlqen, atëherë ajo është nga Allahu. Kështu pra, le ta falënderojë Allahun dhe le t’ua dëftojë atë edhe të tjerëve. Nëse sheh diçka tjetër që nuk e pëlqen, atëherë ajo është nga shejtani, kështu që le t’i mbështetet Allahut për ta ruajtur nga e keqja e saj dhe të mos ia dëftojë atë askujt, sepse ajo nuk do t’i sjellë atij asnjë të keqe.”

Vëllezër të nderuar!

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Ëndrra qëndron në kthetrat e shpendit derisa nuk e shpreh, por atëherë kur e shpreh, bie nga kthetrat e shpendit”.

Jakubi i ka thënë birit të tij se ajo ëndërr është shenjë paralajmëruese madhështore, e ajo është pejgamberia, dhe i ka thënë: “Ashtu siç të ka përzgjedhur Zoti yt dhe të ka mundësuar që të shohësh këto yje me diellin dhe me hënën duke të bërë sexhde ty, do të të zgjedh ty për Vetën e Tij, për të qenë pejgamber për familjen tënde dhe për të tjerët”.

Po ashtu i ka thënë birit të tij se ajo ëndërr është shenjë paralajmëruese se do të jetë në gjendje të bëjë interpretimin e ëndrrave, do ta mësojë interpretimin e tyre.

Do të inspirohet për të kuptuar se çka është e drejtë nga ajo ëndërr.

Jakubi i ka thënë birit të tij: “Allahu Famëlartë plotëson begatinë e Tij ndaj teje, o Jusuf, do të të dërgoj ty pejgamber, po ashtu do ta plotësojë begatinë ndaj fisit të Jakubit dhe të familjes së tij, e aty bëjnë pjesë: babai yt, vëllezërit e tu dhe pasardhësit e tu”. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَكَذَلِكَ يَجْتَبِيكَ رَبُّكَ وَيُعَلِّمُكَ مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ وَيُتِمُّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ وَعَلَىٰ آلِ يَعْقُوبَ كَمَا أَتَمَّهَا
عَلَىٰ أَبَوَيْكَ مِنْ قَبْلُ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ ۚ إِنَّ رَبَّكَ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٦﴾

“Ja, kështu Zoti yt të zgjedh ty, të mëson interpretimin e ëndrrave, plotëson dhuntinë e Tij ndaj teje dhe familjes së Jakubit, sikurse pat plotësuar atë më parë ndaj prindërve tu, Ibrahimit dhe Is’hakut.”
(Jusuf: 6)

Begatia për Jusufin: do të lirohet nga burgu dhe do të sigurohet.

Begatia për Jusufin: do të arrijë autoritet dhe pozitë të lartë në mbretëri.

Është përdorur emri i Ibrahimit para emrit të Is'hakut për të sqaruar se ai është më fisniku dhe është babai i peygamberëve. Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ رَبَّكَ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

“Zoti yt është i Dijshëm, i Urtë!” (Jusuf: 6)

Zoti është i ditur për krijesat e Tij, për të përzgjedhur dhe për të specifikuar.

Zoti e di më së miri se kë ta caktojë peygamber.

Zoti është i Urtë në krijimtarinë e Tij, në projektimin, programimin dhe në planifikimin.

Zoti vepron siç dëshiron dhe çka është e nevojshme dhe përshtatet me situatën reale dhe faktike.

Përfundim

Jakubi e ka kuptuar se:

Njëmbëdhjetë yjet janë njëmbëdhjetë vëllezërit e Jusufit dhe do t'i nënshtrohen, do t'i përulen, do ta nderojnë, do ta respektojnë.

Dielli dhe hëna janë babai i tij dhe nëna e tij, sepse në esencë yjet nuk bëjnë sexhde sikurse njeriu; për këtë arsye fjala bartet në kuptim ëndrre.

Nga ëndrra e Jusufit, Jakubi e ka kuptuar se:

Jusufi do të ketë vlerë të madhe,

Jusufi do ta udhëheqë popullin e tij,

Jusufi do të udhëheqë nënën e tij,

Jusufi do t'i udhëheqë vëllezërit e tij,

Jusufi do ta udhëheqë edhe babanë e tij.

Për këtë arsye i ka thënë që të jetë i kujdesshëm dhe të mos ua tregojë ëndrrën askujt.

Ëndrra ndonjëherë nuk realizohet ashtu siç edhe ndonjëherë plani nuk realizohet.

Ëndrra ndonjëherë realizohet pas një kohe të shkurtër, e ndonjëherë realizohet pas një kohe të gjatë.

Realizimi i ëndrrës nuk ndodh pas një muaji apo viti, edhe pse mund të ndodhë.

Ëndrra e Jusufit a.s. nuk është realizuar pas dhjetë viteve, e as pas njëzet viteve, por është realizuar pas dyzet viteve apo pas tetëdhjetë viteve.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe të tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim si muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E TRETË

KOMPLOTI I VËLLEZËRVE TË JUSUFIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Ne, duke e shpallur këtë Kur'an, po të rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”. (Jusuf, 3)

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin:

“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Do të flas për komplotin në përgjithësi dhe për komplotin e vëllezërve të Jusufit në veçanti. Kjo, pasi kemi folur për ëndrrën e Jusufit a.s. dhe pas konsultimit të tij me babanë e vet.

Brenga dhe frika e njeriut janë çështje të cilat dominojnë në brendi të njeriut.

Dobësia dhe paaftësia e njeriut janë çështje të cilat dominojnë te njeriu.

Egoizmi i njeriut është çështje e cila dominon te njeriu.

Të gjitha këto janë veti negative të cilat njeriu i ushqen në veten e tij dhe i përdor në rastet kur nuk përputhen me bazat morale dhe të etikës, dhe që nuk përkojnë me natyrshmërinë e drejtë.

Kështu kanë vepruar vëllezërit e Jusufit me të – është shembull i rrallë në përgatitjen e kurthit, në xhelozin dhe në komplotizëm të ulët.

Ekzistojnë lloje të kompleteve:

- Komploti ndaj personalitetit,
- Komploti institucional,
- Komploti shtetëror.

Me fjalë të tjera, duke filluar nga denigrimi, nga eliminimi politik e deri te eliminimi fizik, me vrasje, me atentat e kështu me radhë.

Vëllezërit e Jusufit kanë planifikuar: ta likuidonin fizikisht ose institucionalisht.

Vëllezërit e Jusufit kanë planifikuar:

Ose ta mbysin nëpërmjet përdorimit të një mjeti shkaktues të vrasjes. Pra, kanë planifikuar që ta hedhin në një pus të thellë, ashtu që ose të vdesë aty,

Ose le ta marrë me vete ndonjë udhëtar, ashtu që t'i shërbejë ndonjë zotëriu.

Në të dy rastet do të çliroheshin prej tij.

Kjo është formë komploti të cilën e pasqyron Allahu i Madhërishëm se si vëllezërit e Jusufit kanë thënë:

اَقْتُلُوا يُوسُفَ أَوْ اطْرَحُوهُ أَرْضًا يَخْلُ لَكُمْ وَجْهُ أَبِيكُمْ وَتَكُونُوا مِنْ بَعْدِهِ قَوْمًا صَالِحِينَ ﴿٩﴾

“Mbyteni Jusufin ose hidheni diku larg në një vend, e babai juaj t’ju dojë juve, e pas asaj (pendohuni) bëhuni njerëz të mirë.” (Jusuf. 9)

Vëllezër të nderuar!

Çka i ka shtyrë vëllezërit e Jusufit që ta eliminonin Jusufin nga skena familjare?

Vëllezërit e Jusufit a.s. mendonin se babai i tyre e do më së shumti Jusufin a.s. Ata kanë thënë: **“Për Zotin, Jusufi dhe vëllai i tij Benjamini janë më të dashur te babai ynë, përderisa ata janë të vegjël, ndërsa ne jemi burra të fortë dhe jemi shumë”**.

Ata pretendonin se ishin një grup i cili edhe mund të dëmtojë, por edhe të sjellë dobi.

Ata e konsideronin veten të fuqishëm.

Ata pretendonin se ishin një grup i cili mbron edhe nënçmon, pra është e domosdoshme që t’i donte dhe t’i mbronte babai i tyre.

Mendonin se babai i tyre ishte me të vërtetë në humbje të qartë.

Mendonin se babai i tyre nuk vepron drejt.

Mendonin se babai i tyre është ndikuar nga dashuria për Jusufin dhe për vëllanë e tij, dhe se kjo dashuri ka ndikuar që të anashkalojë drejtësinë dhe barazinë.

“Po, si është e mundur të dallohen dy fëmijë të vegjël, të dobët, nuk ka dobi prej tyre, ata nuk janë të barabartë ndaj burrave të fortë!”

“Po, si është e mundur që të duhen dy individë më shumë se një grumbull individësh!”

Kjo logjikë e të menduarit është gabim, sepse Jusufi dhe vëllai i tij ishin jetimë të vegjël, u kishte vdekur nëna e tyre.

Zakonisht prindi:

- të voglin e mëshiron derisa të rritet,
- të sëmurin derisa të shërohet,
- të munguarin derisa të kthehet.

Vëllezërit e Jusufit nuk kanë mundur t'i kuptojnë shkaqet e kësaj mëshire dhe dhembshurie. Për këtë arsye kanë përgatitur komplotin.

Vëllezër të nderuar!

Ka filluar debati në mes vëllezërve ashtu siç debatohet në kuvende komunale për çështje shoqërore:

Njëri vëlla ka thënë:

Babai e do më së shumti Jusufin.

Tjetri ka thënë:

Ne e meritojmë të na dojë më shumë se atë.

I treti ka thënë:

Vërtet babai është në humbje të sigurt.

I katërti ka thënë:

Ta vrasim Jusufin.

I pesti ka thënë:

Hidheni në fund të ndonjë bunari, e merr atë dikush prej udhëtarëve.

I gjashti ka thënë:

Ky i fundit është mendimi më i mirë.

Më i guximshmi ka thënë: "As mos e mendoni që ta vrisni Jusufin, sepse vrasja është krim i madh, ai është vëllai juaj, por hidheni në thellësi të një pusi, ashtu që do ta vërejë ndonjëri nga tregtarët, të cilët udhëtojnë për tregti, kështu që çlirohemi prej tij një herë e përgjithmonë dhe realizohet qëllimi juaj, e ai qëllim është largimi i tij nga babai".

Ky më i guximshmi ka thënë: "Nuk ka nevojë të vritet, nëse veç e keni vendosur ta realizoni atë qëllim, pra që të veproni atë që është më e mira e mundshme për ju. Ky është mendimi im".

Zoti i Madhërishëm thotë:

Njëri prej tyre tha:

قَالَ قَائِلٌ مِّنْهُمْ لَا تَقْتُلُوا يُوسُفَ وَالْقَوْهَ فِي غِيَابَتِ الْجُبِّ يَلْتَقِطُهُ بَعْضُ السَّيَّارَةِ إِن كُنْتُمْ فَاعِلِينَ



“Mos e mbytni Jusufin, e në qoftë se jeni për të bërë diçka, lëshojeni atë në fund të bunarit, do ta marrë atë dikush prej udhëtarëve”. (Jusuf: 10)

Në fund të bisedave për ta eliminuar Jusufin a.s. në përgjithësi janë dhënë dy mendime:

Mendimi i parë: Ta mbysin Jusufin dhe të zgjidhet çështja.

Mendimi i dytë: Ta largojnë dhe dëbojnë në një vend të panjohur, nga ku nuk mund të kthehet te prindi i tij, dhe të absorbohet dashuria e tij për të dhe të kthehet në drejtim tonin.

Ky komplot pasqyron natyrshmërinë e poshtër njerëzore.

Urrejtja, zilia dhe xhelozia kanë ndikuar në një veprim të tillë, pra për të shkaktuar gjakderdhje.

Lakmia dhe interesi personal kanë ndikuar për një veprim të tillë.

Urrejtja dhe xhelozia shkatërrojnë familje dhe shoqëri.

Lakmia dhe interesi personal shkatërrojnë institucione dhe shoqëri.

Kjo, duke pasur parasysh se babai Jakub a.s. nuk e ka dalluar djalin e tij në asgjë tjetër, përpos në dashuri ndaj tij; përderisa dashuria është çështje e zemrës, të cilën nuk mund ta kontrollojë njeriu, për këtë çështje njeriu arsyetohet dhe nuk mallkohet.

Mëkat tjetër i vëllezërve është kur janë pajtuar me ndërprerjen e lidhjeve farefisnore dhe veprimin e egër ndaj vëllait të tyre, duke mos pasur dhembshuri.

Mëkat tjetër i vëllezërve është kur janë pajtuar për të mos respektuar prindin, përderisa e kanë ditur se Jakubi është prej të dërguarve fisnik, sepse është e mundur që Allahu do ta zbulonte veprën e tyre të keqe dhe të shëmtuar.

Vëllezër të nderuar!

Pas përfundimit të diskutimit kanë ardhur në përfundim se pastaj, pas vrasjes së tij apo dëbimit të tij, do të pendohen te Allahu për mëkatin e bërë.

Vëllezërit e Jusufit kanë gabuar kur kanë thënë: “Do të kryejmë krim e pastaj do të pendohemi”, ashtu siç veprojnë disa injorantë, të cilët bëjnë gabime me qëllim e pastaj e bëjnë nijet të pendohen.

Ky veprim është veprim i cekët.

Ky veprim është veprim joserioz.

Ky veprim është tallje, sepse pendimi nuk është atëherë kur insistohet të bëhet krimi.

Ky veprim është veprim i keq, e zhyt njeriun në të keqen dhe në imoralitet.

Me këtë veprim pikësynohet kriminaliteti.

Edhe në ditët e sotme dëgjojmë ndonjërin duke thënë: “Do të falem kur të plakem”.

Ndonjë tjetër e dëgjojmë duke thënë: “Do të shkoj në haxh kur të plakem”.

Ndonjë tjetër e dëgjojmë duke thënë: “Do të agjëroj kur të jem i lirë”, e kështu me radhë.

Ndërsa harron se vdekja mund t'i vijë në befasi, por edhe nëse arrin atë moshë, ai prapë do t'i neglizhojë adhurimet dhe do të vdesë pa u penduar.

Shikoni pra!

Ata kanë qenë të paditur, andaj mos u bëni të paditur.

Ata kanë qenë të verbër, andaj mos u bëni të verbër ndaj realitetit.

Ata kanë qenë lakmitarë, mos u bëni lakmitarë.

Ata nuk e kanë llogaritur rezultatin final të çështjes, andaj llogariteni rezultatin final të çështjeve.

Ata kanë qenë shkurtpamës dhe pa vizion, andaj bëhuni largpamës dhe vizionarë, mos u bëni si vëllezërit e Jusufit.

Ata kanë qenë zemërgurë, mëkatarë ndaj Zotit të tyre. Andaj mos u bëni zemërgurë dhe mëkatarë.

Mos xhelozoni, mos urreni! Zoti i Madhërishëm thotë:

أَيُّحِبُّ أَحَدُكُمْ أَنْ يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا فَكَرِهْتُمُوهُ وَاتَّقُوا اللَّهَ

“... a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut...”
(Huxhurat, 12).

Ata të cilët ia kanë sjellë prindit të tyre në moshë të vjetër të keqen më të madhe të mundshme... e ju bëhuni të mirë ndaj prindërve, sidomos në moshën e pleqërisë! Mos u sillni kokëçarje prindërve me veprimet e juaja.

Për t'u mbrojtur nga zilia ka zbritur sureja e posaçme në Kur'an, e ajo është surja Felek, ku Zoti i Madhërishëm thotë:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ﴿١﴾

مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ﴿٢﴾

وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ﴿٣﴾

وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ﴿٤﴾

وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ﴿٥﴾

“Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit,

Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi.

Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht.

Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja.

Dhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.”

(El-Felek)

Vëllezër të nderuar!

Dashuria dhe urrejtja janë natyrshmëri e njeriut dhe janë pjesë përbërëse të jetës së tij.

Dashuria ka ekzistuar prej Ademit a.s., ndërsa dashuria dhe urrejtja, pra që të dyja, në historinë e njerëzimit kanë filluar prej dy bijve të Ademit a.s. – Habilit dhe Kabilit.

Treguam dashurinë e vërtetë të Jakubit a.s. ndaj Jusufit, tani e kemi dashurinë e rreme të vëllezërve të Jusufit ndaj Jusufit a.s.

Vëllezërit e Jusufit e kanë ditur se rruga më e mirë për të realizuar suksesin e tyre është që të bëjnë komplot ndaj vëllait të tyre, Jusufit a.s.

Mirëpo, pengesë kryesore para tyre ishte mënyra se si ta mashtronin Jakubin a.s.

Atëherë grackën e kanë filluar me paraqitjen se e duan dhe kanë dëshirë ta merrnin me vete.

Kështu pra, me paraqitjen e tyre janë treguar se kinse janë të përgatitur për ta siguruar dhe për ta mbrojtur, kanë treguar se kanë përgatitje dhe aftësi, dhe se ata kanë mundësi që ta ruajnë dhe ta mbrojnë nga ujku.

Vëllezërit e Jusufit paraqiten kinse ata ia duan të mirën vëllait të tyre, paraqiten kinse ata e duan vëllanë e tyre, e këshillojnë për të mirë vëllanë e tyre.

I kanë thënë babait të tyre: “Pse nuk po e lejon që të vijë me ne për t’u argëtuar, pse nuk po e lejon që të vijë me ne për të luajtur, pse nuk po e lejon që të vijë me ne që të ushqehet me të mirat e pemëve dhe perimeve?”

Kjo mënyrë e paraqitjes së dashurisë së tyre dhe dhembshurisë së tyre është bërë nga shkakut se e kanë ditur se babai i tij e do Jusufin.

Kjo mënyrë e zotimit të tyre për ta mbrojtur është bërë nga shkakut se e kanë ditur se babai i tij e do Jusufin, kjo dashuri e babait ndaj Jusufit i ka hidhëruar ata dhe nuk kanë qenë të qetë nga ai fakt. E kanë ditur se babai i tyre e mbron Jusufin a.s.

Duhet pasur kujdes: në qoftë se ndokush paraqitet se të do, mirëpo pas asaj dashurie fshihet diçka e keqe.

Ndonjëri të do për interes personal, e pasi ta arrijë atë interes, largohet nga ti.

Ndonjëri paraqitet se të do, mirëpo ajo dashuri është e rreme, sepse ka për qëllim të përfitojë diçka prej teje.

Kujdes nga dashuria e verbër!

Kujdes nga dashuria e rreme!!

Ata thanë:

قَالُوا يَا أَبَانَا مَا لَكَ لَا تَأْمَنَّا عَلَى يُوسُفَ وَإِنَّا لَهُ لَنَاصِحُونَ ﴿١١﴾

“O baba ynë, ç’ke që nuk na beson për Jusufin, e ne ia duam të mirën atij?” (Jusuf: 11)

Vëllezër të nderuar!

Përderisa vëllezërit e Jusufit e kishin profesion ruajtjen e bagëtisë dhe gjatë ruajtjes së bagëtisë luanin dhe argëtoheshin, atëherë e kanë gjetur edhe arsyen për ta lejuar Jusufin që t’u bashkëngjitej atyre.

Jusufi ishte në moshën e vegjëlisë.

Loja dhe argëtimi për fëmijën është çështje e dashur dhe e pëlqyer, por edhe e lejuar, posaçërisht para moshës së kryerjes së obligimeve.

Loja dhe argëtimi janë të lejuara me qëllim të zgjerimit të krahavorit, përsosjes së fizikut dhe kënaqësisë së shpirtit.

Lejohet që loja të jetë në fushën e cila e strukturon trupin dhe për t’u përgatitur për të ardhmen, si p.sh.: notimi, vrapimi, kalërimi, mundja, gjuajtja me shtiza e me mjete të tjera, e kështu me radhë. Në këtë kontekst e kuptojmë argëtimin dhe lojën.

Loja dhe argëtimi duhet të jenë deri në atë masë saqë, kur të fillojë koha e namazit, falet namazi dhe kryhet obligimi.

Edhe garat janë të lejuara nëse bëhen në fusha të ndryshme dhe nuk neglizhohen obligimet fetare. Prej garave mund të ketë edhe përfitime. Djemtë e Jakubit i kanë thënë babait të tyre:

أَرْسِلْهُ مَعَنَا غَدًا يَرْتَع وَيَلْعَب وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿١٢﴾

“Dërgoje nesër atë me ne, le të hajë pemë dhe le të luajë, se ne me siguri do ta ruajmë atë.” (Jusuf: 12)

Babai i tyre, tashmë plak, fillon t’ua shprehë atyre frikën se, nëse e marrin Jusufin për zbavitje, atëherë ekziston mundësia që ta shqyejë ndonjë ujë.

Babai i tyre, tashmë plak, fillon t’ua shprehë atyre pikëllimin se, nëse e marrin Jusufin për argëtim, atëherë ekziston mundësia që të humbasë.

Mirëpo, vëllezërit e Jusufit i përgjigjen me metodologjinë e tradhtisë, vëllezërit e Jusufit i përgjigjen me metodologjinë e mashtrimit.

I tregojnë faktin babait të tyre se ata ishin një shoqëri prej burrash trima, andaj nuk është e mundur të jenë të paaftë për t'u ballafaquar me ujkun.

Tregojnë faktin se ata ishin të fuqishëm, andaj nuk është e mundur të jenë të paaftë për t'u ballafaquar me egërsirat. Zoti i Madhërishëm thotë: Ata thanë:

قَالُوا لَئِنْ أَكَلَهُ الذِّئْبُ وَنَحْنُ عُصْبَةٌ إِنَّا إِذَا لَلْخَاسِرُونَ ﴿١٤﴾

“Për Zotin, nëse e ha ujku, e duke qenë ne grup kaq i fortë, atëherë ne mos qofshim fare!” (Jusuf: 14)

Arsyetimi i Jakubit a.s. përmban dy çështje:

- Largimi i Jusufit prej tij e pikëllon dhe e mërzit,
- Frika se mund ta shqyejë ujku, eventualisht nëse e lënë pas dore gjatë zbavitjes së tyre.

Kjo i bie sikur dëshironte t'u tregonte me argumente, e njëkohësisht ka qenë edhe përgjigje se nuk u përket atyre që ta teprojnë me vëllanë e tyre, sepse, po qe se ndodh një gjë e tillë, ata do të dështonin, do të shkatërroheshin dhe nuk do të ishte e mirë dhe e dobishme për ta. Zoti i Madhërishëm tregon se Jakubi a.s. ka thënë:

قَالَ إِنِّي لَيَحْزُنُنِي أَنْ تَذْهَبُوا بِهِ وَأَخَافُ أَنْ يَأْكُلَهُ الذِّئْبُ وَأَنْتُمْ عَنْهُ غَافِلُونَ ﴿١٣﴾

“Unë mallëngjehem po të vijë me ju, e edhe kam frikë se do ta hajë ujku, kur mungon kujdesi juaj për të”. (Jusuf: 13)

Vëllezër të nderuar!

Bunari ka qenë i shkretë, nuk ka pasur ujë, ka qenë i shkretë. E kanë hedhur në të.

Pasi e kanë hedhur në bunar, e kanë marrë gjakun e një qengji, e kanë përlyer këmishën me gjakun e qengjit, pra me gjak të falsifikuar, për ta mashtruar babanë e tyre Jakubin.

Në mbrëmje janë kthyer dhe kanë thënë se e ka ngrënë ujku.

Duke pasqyruar këtë veprim të shëmtuar, Allahu i Madhërishëm thotë:

وَجَاءُوا عَلَى قَمِيصِهِ بِدَمٍ كَذِبٍ

“E erdhën (i sollën) në këmishën e tij me gjak të rremë.” (Jusuf: 18)

Jakubi nuk kishte zgjidhje tjetër pos që të duronte, nuk kishte zgjidhje tjetër pos të mbështetej te Allahu nga përshkrimi i imagjinuar dhe nga gënjeshttrat e tyre.

Thëniet e tyre kanë dëshmuar se nuk e kanë treguar të vërtetën dhe se kanë gënjyer, sepse kanë pretenduar se e ka ngrënë ujku.

Ata e kanë ndier në vetvete se janë duke gënjyer kur i kanë thënë babait të tyre: **“Ti nuk na beson neve, edhe po që se e themi të vërtetën”**.

Sikur e kanë treguar veten e tyre se nuk janë seriozë dhe se janë duke gënjyer.

Gënjeshtërs së tyre dhe mashtrimit të tyre ia kanë bashkëngjitur faktin se:

ata e kanë marrë një qengj, e kanë prerë, pastaj me gjakun e qengjit e kanë përlyer këmishën e Jusufit dhe i kanë thënë babait të tyre: **“Ja, kjo është këmisha e tij”**. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَجَاءُوا أَبَاهُمْ عِشَاءً يَبْكُونَ ﴿١٦﴾

قَالُوا يَا أَبَانَا إِنَّا ذَهَبْنَا نَسْتَبِقُ وَتَرَكْنَا يُوسُفَ عِنْدَ مَتَاعِنَا فَأَكَلَهُ الذِّئْبُ ۚ وَمَا أَنْتَ بِمُؤْمِنٍ لَّنَا وَلَوْ كُنَّا

صَادِقِينَ ﴿١٧﴾

“E në mbrëmje erdhën duke qarë te babai i tyre.” Thanë: **“O baba ynë, ne shkuam të bëjmë gara, e Jusufin e lamë te teshat tona dhe atë e kishte ngrënë ujku. Ti nuk do të na besosh neve, edhe po të jemi të vërtetë!”** (Jusuf: 16, 17)

Ata e kanë harruar se Allahu e di gjendjen e tyre, kanë harruar se u ndodh befasia, sepse ata kishin vendosur që Jusufin a.s. ta hidhnin në një pus, të cilin pus ata e dinin se ku ndodhej.

Allahu e ka inspiruar Jakubin që t’u tregonte se çka do të vepronin, ndërsa ata nuk e ndienin se çka e ka inspiruar Allahu peygamberin e Tij. Kjo për shkak të qëndrimit të dobët të tyre dhe njohurisë së cekët të tyre.

Allahu e ka inspiruar Jakubin që t’u tregonte se çka do të vepronin, ndërsa ata nuk e ndienin se çka e ka inspiruar Allahu peygamberin e Tij. Kjo për shkak të shkurtpamësisë së tyre.

Situata mbaron në mënyrë të poshtër.

Situata mbaron në mënyrë katastrofale.

Vëllezërit e tyre kriminelë kthehen në fund të ditës te babai i tyre me arsyetim mashtrues, vëllezërit e tyre kriminelë kthehen në fund të ditës te babai i tyre me sajim gënjeshtre.

Ata qanin në mbrëmje me lot mashtrimi. Mos e mashtroni babanë tuaj!

Ata e gënjenin babanë e tyre. Mos e gënjeni babanë tuaj!

Ata pretendonin se përderisa ata ishin argëtuar dhe kishin garuar në garën e vrapimit, Jusufin e kishin caktuar si roje të gjësendeve të tyre.

Jakubi e ka marrë në dorë këmishën, e ka fshirë fytyrën e tij me atë këmishë dhe ka qarë.

Pastaj i ka dhënë motiv vetes së tij, sepse e ka parë se këmisha nuk ishte e gërvishtur dhe nuk kishte shenja të thonjve shqyes, dhe me këtë e ka argumentuar se është gjak i falsifikuar, dhe u thotë atyre: **“Sa i butë paska qenë ujku, e ka ngrënë Jusufin, ndërsa nuk ia ka gërvishtur këmishën e tij!”**.

Ky është argument në fikh dhe në gjykata se “duhet të paraqiten faktet bindëse në atë që pretendohet”.

Përfundim

Jakubi u thotë atyre: **“E keni zbukuruar veten tuaj me çështjen e keqe dhe të papëlqyeshme, me atë që ju nuk ju kujtohet...”**

Ai tha:

قَالَ بَلْ سَوَّلَتْ لَكُمْ أَنْفُسُكُمْ أَمْرًا فَصَبْرٌ جَمِيلٌ وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ عَلَىٰ مَا تَصِفُونَ ﴿١٨﴾

“Jo, (nuk e ka ngrënë ujku), por epshet tuaja ua hijeshuan punën. Halli im është: durim i mirë. Allahu është Ai prej të cilit kërkohet ndihmë për këtë që përshkruani”. (Jusuf: 18)

Jakubi ka thënë: “Sa më përket mua, më mirë është që të duroj për çështjen për të cilën jeni dakorduar.”

Sa më përket mua, më mirë është t'i mbështetem Allahut në atë që ju e keni përshkruar derisa të kalojë pikëllimi dhe mërzia”.

Sa më përket mua, më mirë është t'i mbështetem Allahut në atë që ju e keni përshkruar derisa të tejkalohet fatkeqësia”.

Ky është dorëzim i çështjes te Allahu dhe kjo është mbështetje te Ai.

“Durimi i mirë”: është mosankimi. Mos u anko me nevojë dhe pa nevojë.

Për këtë arsye, kur është pyetur njëri prej të urtëve për sprovat të cilat e godasin njeriun se a janë dënim prej Allahut, fshirje e mëkateve apo ngritje në nivele të larta, është përgjigjur: *“Nëse të godet e keqja dhe hidhërohesh, dije se është dënim prej Allahut; nëse duron, atëherë është fshirje e mëkateve, ndërsa nëse pajtohesh, atëherë është ngritje në nivel të lartë.”*

Durimi është çelës i çlirimit nga fatkeqësitë.

“Durimi i mirë”: është rrugë për të mposhtur rreziqet.

“Durimi i mirë”: është mjet për të mposhtur fatkeqësitë.

Kur e kanë pyetur njërin prej dijetarëve: “Çka është durimi i mirë?” është përgjigjur: “Është atëherë kur sprovohesh, ndërsa zemra të thotë: ‘E falënderoj Zotin’.”

Ka thënë njëri prej dijetarëve: “Po të ishte kjo botë e lehtë pa vështirësi, nuk do të ishte durimi një derë prej dyerve të Xhenetit”.

Duroni me durim të mirë, se Zoti është me durimtarët.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim si muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E KATËRT

SHPËTIMI I JUSUFIT NGA SHKATËRRIMI PREJ BUNARIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përshëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Ne, me të shpallur të këtij Kur'ani, po të rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”. (Jusuf, 3)

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin:

"Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson." (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Sot do të flas se si ka shpëtuar Jusufi a.s. pasi e kanë hedhur në bunar.

Do të flas për përfitimet dhe mësimet nga ajo pjesë e historisë.

Njerëzit gabojnë kur mendojnë se planet e tyre nuk bien ndesh me diçka që është më i fuqishëm se ata.

Njerëzit gabojnë kur mendojnë se programet e tyre nuk bien ndesh me diçka që është më i fuqishëm se ata.

Planifikimi i çështjeve përmban dispozitat dhe zbatimin, ndërsa fuqia dhe dëshira e Allahut dhe programi i Tij përfshijnë çdo gjë.

Asgjë në gjithësi nuk ndodh pa dëshirën e Zotit.

Dëshira e Zotit realizohet.

Dëshira e Zotit triumfon.

Planifikimi i Zotit është ligj, sepse Ai është mposhtësi dhe mbizotëruesi i çelësave të qiejve dhe të tokës.

Vëllezërit e Jusufit, edhe pse kanë planifikuar që njëherë e përgjithmonë të çlirohen nga vëllai i tyre, prapë se prapë kanë dështuar dhe nuk ia kanë arritur qëllimit.

Pse?

Allahu i Madhërishëm është mbizotërues, i Cili realizon çka të dojë Ai.

Allahu i Madhërishëm e ka caktuar që vështirësia të mos i zgjasë shumë Jusufit në pus.

Allahu i Madhërishëm e ka caktuar që vetmia e Jusufit a.s. të mos i zgjasë shumë në pus.

Allahu i Madhërishëm e ka caktuar që përjetimi i egër të mos i zgjasë shumë në pus.

Pranë bunarit kalon një karvan, pra një grup udhëtarësh të cilët udhëtonin nga Medjeni për në Egjipt.

Udhëtarët të cilët udhëtojnë në largësi të gjatë, më së shumti kanë nevojë për ujë.

Gjatë rrugëtimit, në mes të rrugës, e dërgojnë njërin prej udhëtarëve të mbushë ujë në bunar, të cilin e kanë hasur gjatë rrugës së tyre afër qytetit të Jordanisë, përafërsisht 15 kilometra larg tij.

Shërbyesi i karavanit shkon për të mbushur ujë.

E zbret poshtë kovën për ta mbushur me ujë.

Në të vendoset Jusufi dhe mbahet për litari, dhe ngjitet lart së bashku me kovën.

Shërbyesi, i gëzuar për veten e tij dhe për të tjerët të cilët ishin me të, thotë: “Çfarë gëzimi i madh për ne! Urime, urime, ky është një djalosh!”

Duke përshkruar mënyrën e shpëtimit të Jusufit a.s. nga errësira e thellë e pusit, Allahu i Madhërishëm thotë:

وَجَاءَتْ سَيَّارَةٌ فَأَرْسَلُوا وَارِدَهُمْ فَأَدْلَى دَلْوَهُ قَالَ يَا بُشْرَىٰ هَذَا غُلَامٌ وَأَسَرُّهُ بِضَاعَةً وَاللَّهُ عَلِيمٌ

بِمَا يَعْمَلُونَ ﴿١٩﴾

“Dhe aty pari kaloi një grup udhëtarësh, e e dërguan ujëbartësin (për ujë), e ai e lëshoi kovën e vet (në bunar) dhe tha: ‘Myzhde! Qe një djalosh!’” (Jusuf: 19)

Ndoshta je në bunarin e jetës i vetmuar, por mos harro se Zoti mundet të të shpëtojë! Zoti mundet që të caktojë ndonjë karavan për të të shpëtuar nga vetmia, nga humbja.

Vëllezër të nderuar!

Në atë kohë Jusufi ishte shtatë vjeç.

E marrin me karvanin e tyre.

E mbajnë sekret nga bashkëudhëtarët e tjerë, duke thënë se është mall tregtar. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَأَسْرُوهُ بَضَاعَةً

“Ata e fshehën atë si mall tregtie.” (Jusuf: 19)

Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë.

Allahu di për veprimin e tyre.

Allahu di edhe për veprimet tuaja.

Atij nuk mund t'i fshihet ajo se atë e kanë fshehur brenda mallit të tyre.

Allahut nuk mund t'i fshihet nëse fshihni brenda mallit tuaj.

Andaj,

mos mendo se Zoti nuk i di sekretet tuaja!

Mos mendo se Zoti nuk i sheh veprimet tuaja!

Nëse mban ndonjë sekret, mos mendo se Allahu nuk do t'i zbulojë sekretet e tua!

Nëse bën ndonjë veprim, Allahu e di veprimin tënd, edhe nëse nuk e di askush tjetër pos teje. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِمَا يَعْمَلُونَ

“Po Allahu e dinte shumë mirë se ç'vepronin ata.” (Jusuf: 19)

Kjo është një shenjë e dëshirës së Allahut Famëlartë për Jusufin, dhe rrjedhojë se gjërat ndodhin varësisht siç i parasheh Allahu.

Vëllezër të nderuar!

Ndonjëherë njeriut të mirë nuk ia dinë vlerën!

Ndonjëherë vlerën tënde nuk e dinë të tjerët!

Të vlerësojnë pak apo nuk të vlerësojnë fare!

Por më e rëndësishmja është me pasë vlerë te Zoti, edhe nëse të tjerët nuk të vlerësojnë.

Këtë djalosh të mirë e shesin me çmim të lirë.

E shesin me çmim më të lirë se çmimi i tregut, thjesht me disa dërhëmë. Dërhëmët e asaj kohe nuk kanë pasur vlerë të madhe.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَشَرَوْهُ بِثَمَنٍ بَخْسٍ دَرَاهِمَ مَعْدُودَةٍ وَكَانُوا فِيهِ مِنَ الزَّاهِدِينَ ﴿٢٠﴾

“Dhe e shitën atë (Jusufin) për një çmim të vogël, për disa dërhëmë (masë argjendi) të numëruar, sepse në mesin e tyre pati asish që nuk lakmuan (për çmim më të lartë).” (Jusuf: 20)

Ata nuk janë interesuar për më shumë se katërdhjetë dërhëmë; për këtë shitblerje do të kishin kërkuar edhe më shumë, por nuk e kanë ditur vlerën e çmueshme të tij.

Ata kanë dashur që sa më shpejt të lirohen nga ai djalosh, por nuk e kanë ditur pozitën dhe vlerën e tij te Allahu.

Nëse njerëzit nuk të vlerësojnë, mos mendo se Zoti nuk të vlerëson.

Në këtë kemi ngushëllimin për Pejgamberin a.s. në atë çka e godet atë nga Kurejshitët, sepse përfundimi i takon të devotshmëve.

Në këtë kemi ngushëllimin për Pejgamberin a.s. se duhet pasur parasysh përfundimi i çështjeve. Duhet pritur rezultatin final.

Nëse je i devotshëm, dije se përfundimi i mirë i takon të devotshmëve.

Jusufin e ka blerë Azizi i Egjiptit, pra i pari i policisë; emri i tij ka qenë “Katfirë”.

Azizi ka qenë përgjegjës për depot shtetërore.

Azizi, i cili e kishte blerë Jusufin, i thotë gruas së tij Zulejhasë:

“Nderojë dhe respektojë,

jepi pozitë nderi te ne,

sillu mirë me të dhe mos e konsidero si skllav!

Mos e konsidero si skllav, se ndoshta do të jetë i dobishëm dhe në interes tonin!

Mos e konsidero si skllav, se ndoshta do ta birësojmë, kur të arrijë pjekurinë dhe do të bëhet i zgjeruar”.

Kjo nga shkakun se ajo ishte shterpë.

E ai që e bleu nga Misiri (Egjipti) i tha gruas së vet: “Bëni pritje të kënaqshme, se është shpresë t’ia shohim hajrin ose ta adoptojmë për fëmijë!”

Shikoni, vëllezër: të afërmit nuk e kanë nderuar, përkundrazi e kanë urreyer dhe e kanë xhelozuar Jusufin, ndërsa i huaji e ka nderuar dhe e ka respektuar.

Vëllezër të nderuar!

Dëshira dhe përkujdesja e Allahut e ka përfshirë Jusufin a.s.

Ashtu siç e ka shpëtuar Allahu nga mbytja dhe nga pusi, ka mbjellë simpati në zemrën e Azizit; e ka përvetësuar dhe e ka përfitur dashurinë e Azizit.

Azizi ishte udhëheqës në Egjipt, kështu që i dhuron pozitë të lartë në atë vend.

Më pastaj e emëron administrator të ekonomisë.

Allahu ia ka mësuar interpretimin e ëndrrave.

Allahu është Mbizotërues dhe Triumfues.

Dëshirën e Tij për të realizuar diçka nuk mund ta pengojë askush.

Askush nuk mund ta kundërshtojë dëshirën e Tij.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَقَالَ الَّذِي اشْتَرَاهُ مِنْ مِّصْرَ لِامْرَأَتِهِ أَكْرِمِي مَثْوَاهُ عَسَىٰ أَنْ يَنْفَعَنَا أَوْ نَتَّخِذَهُ وَلَدًا ۚ وَكَذَٰلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ وَلِنُعَلِّمَهُ مِن تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ ۚ وَاللَّهُ غَالِبٌ عَلَىٰ أَمْرِهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

﴿٢١﴾

“Ja, kështu (sikurse e shpëtuan nga bunari), Ne i bëmë vend Jusufit në tokë (në Egjipt), e që t’ia mësojmë atij shpjegimin për disa ëndrra. Allahu është mbizotërues i punës së Vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve).” (Jusuf: 21)

Përfundim

Jusufi a.s. e arrin moshën e pjekurisë.

E ka arritur nivelin e burrërisë, pra i është përsosur forca fizike dhe intelektuale.

Moshë e pjekurisë dhe burrërisë llogaritet të jetë në mes të viteve 30-40.

Kjo është edhe mosha më e rëndësishme e jetës, kur fillon mosha për të marrë përgjegjësi të rëndësishme të jetës.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُ آتَيْنَاهُ حُكْمًا وَعِلْمًا وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿٢٢﴾

“E kur e arriti pjekurinë e tij, Ne i dhamë pushtet e dituri. E kështu Ne i shpërblejmë punëmirët.” (Jusuf: 22)

Allahu i ka dhënë urtësi Pejgamberit a.s.

Allahu e ka shpërblyer ashtu që t'i veprojë punët në të mirën e tij.

Jusufi a.s. i ka kryer punët me mirësi dhe në devotshmëri ndaj Allahut të Madhërishëm, dhe për këtë është shpërblyer nga Allahu; pra, Allahu e ka shpërblyer me mirësi, me devotshmëri.

Kjo dëshmon se:

mirësia dhe devotshmëria ndikojnë në bardhësinë e shpirtit,

mirësia dhe devotshmëria ndikojnë në ndriçimin e zemrës,

mirësia dhe devotshmëria ndikojnë në zhvillimin e intelektit.

E keqja ndikon në prishjen e zemrës.

E keqja ndikon në keqkuptimin e çështjeve.

Nuk ka fjalë më të mirë se fjala e Zotit, kur thotë: **“Dhe Ne, kështu i shpërblejmë bamirësit”**.

Ky ka qenë një premtim për Pejgamberin a.s., ashtu që të mos brengoset për veprimet e pabesimtarëve dhe për arrogancën e tyre.

Ky është premtim për çdo bamirës dhe përgëzim për përfundimin e mirë të tyre.

Allahu i Madhërishëm ka thënë:

“Për bamirësit ka shpërblime edhe më të mira. I orienton në vlera fisnike dhe me vepra të moralit, dhe ua kompenson me të mira, me begati dhe me mirësi”.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim si muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E PESTË

HISTORIA E JUSUFIT ME GRUAN E AZIZIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne, me të shpallur të këtij Kur'ani, po të rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”. (Jusuf, 3)**

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf, 111)**

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Jusufi a.s. ishte me pamje të mirë, i bukur, tërheqës me fizikun e tij dhe me konstrukt të përkryer.

Bukuria dhe pamja e mirë kanë ndikuar që Jusufi a.s. të ballafaqohet me sprovë të rrezikshme.

Kësaj radhe, Jusufi është ballafaquar me sprova edhe më të rrezikshme se me vëllezërit e tij: sprova me Zulejhanë, sprova me gruan e Azizit.

Gjysma e bukurisë i është dhuruar Jusufit a.s.

Kjo ka ndikuar që të sprovohet me të gruaja e udhëheqësit të Egjiptit, e cila ka pasur qëllime të caktuara me të.

Mirëpo,

Allahu e ka mbrojtur pejgamberin e Tij, e ka mbrojtur:

- që të mos bjerë në imoralitet,
- e ka shpëtuar nga shpifjet dhe intrigat,
- e ka siguruar nga akuzimet,
- e ka larguar nga mendimet e këqija ndaj tij.

Nga hadithet e Pejgamberit a.s. kemi mësuar se: një prej shtatë personave i cili do të strehohet dhe do të shpëtojë në Ditën e Gjykimit është i riu të cilin e thërret një grua me pozitë dhe e bukur që të bëjë imoralitet me të, e ai thotë: “Unë i frikësohem Allahut!”

Edhe Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ruaje Zotin, Zoti të ruan ty”. Me fjalë të tjera, ruaju dhe zbatoji ligjet e Zotit, Zoti do të kujdeset dhe do të të ruajë ty.

Kështu pra,

frika ndaj Allahut është gjëja kryesore që pengon për veprimin e mëkateve.

Gjëja më e madhe që ndalon nga rënia në mëkate është dija e bindja se Allahu të sheh.

Gruaja që e ka ftuar për të bërë imoralitet me Jusufin ka qenë me pozitë në shoqëri, e pasur, ka qenë e bukur, e dalluar nga femrat e tjera, kështu joshja është më e madhe për të rënë në mëkat, dhe se ajo vetë e ka ftuar për të bërë imoralitet, e megjithatë Jusufi ka thënë: “Unë i frikësohem Allahut!”

Pra, gruaja e Azizit deshi ta përvetësonte për veten e saj. Në fakt, ftesë për kontakt intim.

Pasi ajo i ka mbyllur të gjitha dyert, i thotë: “Eja tek unë, pra afrohu dhe kryej aktin intim”.

Duke u mbështetur te Zoti i tij, ai thotë: “Asnjëherë, Zoti më mbrojtë nga kjo! Pra, i mbështetem Allahut dhe te Ai strehohem nga injorantët”.

Jusufi a.s. ka thënë:

Pa dyshim se zotëria im, Kitfiri është, [dhe] vlera ime dhe pozita të cilën e kam te ai...

Nuk e tradhtoj zotërinë tim, sepse kriminelët janë të pasuksesshëm.

Ata të cilët e kthejnë të mirën me të keqe e mohojnë bamirësinë, janë të dështuar.

Nuk është e drejtë që ta tradhtoj.

Ai më ka fisnikëruar,

ai më ka akomoduar,

ai më ka nderuar.

Ai i cili respekton të mirën ndaj njeriut, ai e respekton të mirën edhe ndaj Zotit të tij; nuk mëkaton dhe nuk i kundërshton urdhrat e Zotit. Allahu i Madhërishëm thotë:

وَرَأَوْنَاهُ الَّذِي هُوَ فِي بَيْتِهَا عَنْ نَفْسِهِ وَغَلَّقَتِ الْأَبْوَابَ وَقَالَتْ هَيْتَ لَكَ قَالَ مَعَاذَ اللَّهِ إِنَّهُ رَبِّي أَحْسَنَ مَثْوَايَ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٣﴾

“E ajo, në shtëpinë e së cilës ishte Jusufi, i bëri lajka atij dhe ia mbylli dyert e i tha: ‘Eja!’ Ai (Jusufi) tha: ‘Allahut i qofshim falë! Ai zotëria im (e burri yt) më nderoi me vendosje të mirë (si mund t’i bëj hile në familje)?’ S’ka dyshim se tradhtarët nuk kanë sukses.” (Jusuf: 23)

Kur’ani fisnik e ka shprehur në mënyrë të qartë dhe me argumente logjike: Zulejhaja nxiton që të kontaktojë intimisht me Jusufin; Jusufi nuk ka tentuar që t’i bëjë asaj ndonjë të keqe.

Jusufi i ka parë argumentet dhe faktet e Zotit të tij, e ai fakt është ligji i Allahut të Madhërishëm për të mos bërë prostitucion.

Kur’ani fisnik e ka shprehur në formë të prerë dhe praktike: Zulejhaja nxiton që të kontaktojë intimisht me Jusufin, përderisa, deri në atë kohë, Jusufi – i cili ende nuk ishte peygamber – nuk ka tentuar që t’i bëjë asaj ndonjë të keqe.

Pa dyshim se,
po të mos ishte argumenti i Zotit të tij, do ta vepronte dhe do të bënte mëkat.

Ai fakt është se dituria që, prostituti meriton ndëshkim dhe dënim, dhe të menduarit në dënimin prej Allahut, paralajmëron për mëkate.

Kjo është ajo e cila e ka penguar që të tentojë të bëjë keq. Kjo, sepse frika ndaj Allahut është bazë e cila mbron njeriun nga rrëshqitja në mëkate dhe nga devijimi.

Kjo, sepse frika ndaj Allahut është bazë e cila e bën njeriun të vendosur e të moralshëm para ngacmimeve dhe metodave të sprovave.

Kështu jemi mbrojtur dhe jemi siguruar nga të këqijat, nga imoraliteti dhe nga çdo çështje [e keqe].

Jusufi është prej robërve të zgjedhur të cilët Allahu i ka caktuar për pejgamber dhe për shpallje, ndërsa shejtani nuk mund t'i mashtrojë, siç thotë Zoti i Madhërishëm:

وَلَقَدْ هَمَّتْ بِهِ وَهَمَّ بِهَا لَوْلَا أَنْ رَأَىٰ بُرْهَانَ رَبِّهِ كَذَلِكَ لِنَصْرِفَ عَنْهُ السُّوءَ وَالْفَحْشَاءَ إِنَّهُ مِنْ

عِبَادِنَا الْمُخْلَصِينَ ﴿٢٤﴾

“Ajo e mësyu atë qëllimisht, e atij do t'i shkonte mendja ndaj saj, sikur të mos i prezantohej argumenti nga Zoti i tij. Ashtu (e bëmë të vendosur) që të largojmë nga ai të keqen dhe të ndytën. Vërtet, ai ishte nga robërit tanë të zgjedhur.” (Jusuf: 24)

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَاسْتَبَقَا الْبَابَ وَقَدَّتْ قَمِيصَهُ مِنْ دُبُرٍ وَالْفَيَا سَيِّدَهَا لَدَى الْبَابِ

“Dhe që të dy ata u ngutën kah dera, e ajo ia grisi këmishën nga mbrapa dhe pranë dera ata të dy takuan burrin e saj.” (Jusuf: 25)

Ka ndodhur një çast i befasishëm.

Derisa ajo ishte te dera, Jusufi dëshironte të ikte, ndërsa Zulejhaja i shkon mbrapa për të mos e lejuar të dilte nga dhoma dhe e takon gjatë vrapit.

Ia shqyen këmishën nga mbrapa.

Në atë moment burri i Zulejhasë, Azizi i Egjiptit, hyn.

Në atë pozitë të vështirë Zulejhaja sajon shpifje për të, duke i thënë burrit të saj:

قَالَتْ مَا جَزَاءُ مَنْ أَرَادَ بِأَهْلِكَ سُوءًا إِلَّا أَنْ يُسْجَنَ أَوْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“Çfarë mund të jetë ndëshkimi i atij që tenton të keqen në familjen tënde, përpos të burgoset ose [të marrë] dënim të dhembshëm?” (Jusuf, 25)

Jusufi meriton burgun ose dënim të dhembshëm.

Jusufi në mbrojtje të vetes së tij thotë: “Ajo është e cila ka dashur të më përvetësojë për veten e saj”, siç tregon ajeti kur’anor:

Ai (Jusufi) tha: “Ajo m'u vërsul mua!”

Mirëpo,

një pjesëtar i familjes së saj kishte qenë dëshmitar okular; ai dëshmitar okular ka qenë fëmija në djep. Allahut nuk i shpëton asgjë, kështu që i jep gjuhë që të flasë një fëmije të vogël në djep dhe të tregojë historinë, i cili thotë:

Nëse këmisha është e shqyer përpara (në gjoks), atëherë ajo e ka thënë të vërtetën, ndërsa ai (Jusufi) gënjen.

Nëse këmisha është e shqyer nga mbrapa (në shpinë), atëherë ai e ka thënë të vërtetën, ndërsa ajo (Zulejhaja) gënjen.

Zoti i Madhërishëm thotë:

قَالَ هِيَ رَاوَدَتْنِي عَنْ نَفْسِي ۚ وَشَهِدَ شَاهِدٌ مِّنْ أَهْلِهَا إِن كَانَ قَمِيصُهُ قُدَّ مِنْ قُبُلٍ فَصَدَقَتْ وَهُوَ مِنَ

الكَاذِبِينَ ﴿٢٦﴾

وَإِن كَانَ قَمِيصُهُ قُدَّ مِنْ دُبُرٍ فَكَذَبَتْ وَهُوَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٢٧﴾

“Një dëshmitar nga familja e saj gjykoj: ‘Nëse këmisha e tij është grisur përpara, ajo ka thënë të drejtën, kurse ai gënjen. E nëse këmisha e tij është grisur prapa, atëherë gënjen ajo, kurse ai është i drejtë.” (Jusuf: 26, 27)

Ky është argument se lejohet të merren për bazë faktet dhe gjurmët në gjykime dhe në marrje të vendimeve.

Pasi faktet ishin në anën e Jusufit dhe tregonin pafajësinë e tij, dhe burri i Zulejhasë e vërtetoi se gruaja e tij ishte gënjeshtare, thotë: “Ky akuzim është prej grackave të juaja, o ju gra!”

Grackat e grave e tradhtitë e tyre ndikojnë seriozisht në shpirtra.

Grackat e grave ndikojnë aq shumë saqë burrat nuk mund të ndikojnë më shumë se ato.

Shumë herë tradhtitë e tyre zënë vend, ndërsa ti, Jusuf, largohu nga kjo bisedë e kësaj ngjarjeje dhe mos bisedo më tutje për këtë ngjarje.

Akuzimi është rikthyer te vetë gruaja e Azizit; është vërtetuar se ajo është gabimtare.

Mos e përhap këtë lajm te njerëzit!

Ti, grua, kërko falje për mëkatin tënd!

Ti je gabim dhe ti je mëkatore.

Zoti i Madhërishëm tregon:

فَلَمَّا رَأَىٰ قَمِيصَهُ قَدْ مِنْ دُبُرٍ قَالَ إِنَّهُ مِنْ كَيْدِكُنَّ إِنَّ كَيْدَكُنَّ عَظِيمٌ ﴿٢٨﴾

يُوسُفُ أَعْرِضْ عَنْ هَذَا وَاسْتَغْفِرِي لِذَنْبِكِ إِنَّكِ كُنتِ مِنَ الْخَاطِئِينَ ﴿٢٩﴾

“E kur e pa ai (burri i saj) këmishën e tij të grisur prapa, tha: ‘Kjo është dredhi juaja, vërtet dredhia juaj është e madhe! Jusuf, largohu nga kjo (mos ia përmend askujt)! E ti (grua) kërko falje për mëkatin tënd, se vërtet ti qenke fajtores!’” (Jusuf: 28, 29)

Kjo është një provë e madhe të cilën e ka kaluar Jusufi në moshën e rinisë.

Kjo është një provë e madhe të cilën e ka kaluar Jusufi para peygamberisë.

Në moshë të rinisë e ka mbrojtur Zoti i tij, sepse kjo ka qenë siguri dhe mbrojtje prej Allahut: “Mbroje Allahun, Allahu të mbron ty”.

Allahu ka dashur ta pastrojë,

Allahu ka dashur t'ia përsosë moralin dhe nderin, që të jetë përgatitje për gradën e peygamberisë dhe të shpalljes, dhe që t'i paraqitë njerëzimit se është e mundur devotshmëria ndaj Allahut.

Ky është shembull të cilin duhet ta marrin parasysh të rinjtë: se autoriteti i pastër është i të devotshmëve të mirë.

Ky është shembull të cilin duhet ta marrin parasysh burra e gra: se përfundimi i mirë është i të devotshmëve të mirë.

Vëllezër të nderuar!

Dëshmitari okular i cili ka dëshmuar për rastin e Jusufit është dëshmitari foshnje, i cili është prej foshnjave që kanë folur në djep, përpos rastit të Isait a.s., të birit të Mejremes.

Prej foshnjave të cilat kanë folur në djep është edhe rasti i një gruaje tjetër:

Një grua izraelite po i jepte gji të birit. Pranë saj rastësisht kaloi një kalorës i bukur. Ajo tha:

“O Zoti im, bëje djalin tim t'i përngjajë këtij kalorësi!” Djali e lëshoi gjirin, u kthye nga kalorësi dhe tha: “O Zoti im, mos më bëj si ky!” Pastaj përsëri vazhdoi të pinte.

Pastaj sollën një robëreshë dhe po e rrihnin, ndërkaq e ëma e djalit tha: “O Zoti im, mos e bëj djalin tim si kjo!”

Ai e lëshoi gjirin dhe tha: “O Zoti im, më bëj si kjo!”

“Pse?” – e pyeti e ëma. Ai iu përgjigj: “Kalorësi është njeri i keq e gjakpirës, kurse për robëreshën thonë se ka vjedhur dhe ka bërë zina, kurse ajo nuk ka bërë asgjë nga këto.”

Prej foshnjave të cilat kanë folur është edhe rasti me Xhurejxin, të cilin rast do ta shpjegojmë ndonjëherë tjetër.

Vëllezër të nderuar!

Natyrshmëria e shëndoshë nuk e pranon që burri apo gruaja të kryejnë veprime të imoralitetit.

Kodi i nderit e fisnikërisë nuk e pranon që burri apo gruaja të kryejnë veprime të imoralitetit.

Kodi i moralit nuk e pranon që burri apo gruaja të kryejnë veprime të imoralitetit.

Posaçërisht kur është në pyetje çështja e grave të udhëheqësve apo qeveritarëve, sepse pozita e tyre nuk e lejon denigrimin e pozitës së funksionarit qeveritar dhe i bën ata të zbresin në nivele të ulëta e çështje të poshtra, pasi pozita e tyre është që ata të pasohen prej të tjerëve.

Çdo herë kur një njeri ngrihet lart, paralelisht ngrihet niveli i nderit dhe paralelisht sprovohet nderi.

Çdo herë kur një njeri ngrihet lart, paralelisht ngrihet niveli i përgjegjësisë dhe paralelisht sprovohet fisnikëria e tij.

Për këtë arsye, gratë e Egjiptit nuk kanë dashur që të përhapet lajmi për Zulejhanë, gruan e Azizit.

Kanë dashur që ta mbyllin atë çështje, thujse nuk ka ekzistuar, dhe kanë dashur ta largojnë të keqen prej saj. Mirëpo, katër gra e kanë përhapur këtë lajm, e ato ishin:

- gruaja bukëpjekëse e Azizit,
- shërbyesja,
- gruaja e mirëmbajtjes së pallatit, dhe
- gruaja rojtare e pallatit.

Këto të befasuara kanë thënë: “Gruaja e mbretit ka dashur ta përvetësojë djaloshin për veten e saj dhe të bëjë imoralitet me të”.

Ky qëndrim përshkruhet në thënien e Allahut Famëlartë:

﴿ وَقَالَ نِسْوَةٌ فِي الْمَدِينَةِ امْرَأَتُ الْعَزِيزِ تُرَاوِدُ فَتَاهَا عَنْ نَفْسِهِ قَدْ شَغَفَهَا حُبًّا إِنَّا لَنَرَاهَا فِي ضَلَالٍ

مُبِينٍ ﴿٣٠﴾

“Një grup nga gratë e qytetit thanë: ‘Gruaja e zotërisë (e ministrit) i vërsulet marrëzisht shërbëtorit të vet, atë e ka kapluar në shpirt dashuria, e ne jemi të bindura se ajo është në humbje të hapët.”
(Jusuf: 30)

Ato kanë thënë: “Ka mbizotëruar dashuria e zemrës së zezë të saj; nuk i ka analizuar pasojat e atij veprimi.”

Ato kanë thënë: “Ne mendojmë se me veprimin e saj ajo ka bërë gabim të madh, larg nga realiteti.”

Ato kanë thënë: “Ne mendojmë se ajo është injorante, duke pasur parasysh se çfarë pozite posedon.”

Ky mendim i tyre për Zulejhanë ka qenë i pritshëm dhe mendim logjik.

Jusufi a.s. ka refuzuar çdo veprim, saqë edhe të vuajë burgun, vetëm e vetëm që të shpëtojë nga sprovat e grave.

Zulejhaja dëgjon të përfolurat e grave, dëgjon fjalët e këqija të tyre dhe akuzimet ndaj saj. Për këtë arsye:

Ka organizuar një aheng,

i ka ftuar në një ndejë të qetë dhe fisnike,

ka përgatitur një ndejë solemne,

ka përgatitur terren që të mbështeten në shtroja dhe jastëkë.

Pastaj,

vendos lloje të ndryshme të pemëve, lloje të ndryshme të ushqimeve dhe lëngjeve.

Secilës prej tyre u jep nga një thikë që të qërojnë portokaj dhe llojet e tjera të ushqimit, prej llojeve të mishit dhe të pemëve.

Pastaj e urdhëron Jusufin të hyjë në atë ambient, pasi më herët e kishte fshehur në një vend të afërt.

E ka shfrytëzuar kohën e përshtatshme, saktësisht kohën kur ato ishin duke ngrënë dhe duke qëruar lëvozhgat e pemëve.

Jusufi hyn në atë ambient; ato befasohen me bukurinë e tij të paparë dhe të mrekullueshme.

Kanë filluar t'i presin duart e tyre nga befasia e pamjes së tij.

Me shpejtësi kanë thënë: “Për Zotin, atë mund ta bëjë vetëm Zoti dhe askush tjetër!”

Të impresionuar nga bukuria e pakrahasueshme e Jusufit, kanë thënë se ky nuk është njeri, ky mund të jetë vetëm një melek prej melekëve në formë njeriu.

Me këtë deklaram të tyre kanë dashur të shprehin bukurinë madhështore të tij, sepse nuk mund të imagjinohet diçka më e bukur se meleku dhe më e keqe se shejtani.

Ngjasimi me melek është ngjasim i çështjes madhështore, edhe pse ato nuk i shohim.

Pastaj,

gruaja e Azizit thotë: “Unë ia arrita qëllimit për të treguar bukurinë e djaloshit: kjo është ajo për të cilën më keni mallkuar dhe më keni llogaritur fajtores.”

Këtë ngjarje Zoti e tregon si në vijim:

فَلَمَّا سَمِعَتْ بِمَكْرِهِنَّ أَرْسَلَتْ إِلَيْهِنَّ وَأَعْتَدَتْ لَهُنَّ مُتَكَاً وَآتَتْ كُلَّ وَاحِدَةٍ مِّنْهُنَّ سِكِّينًا وَقَالَتِ
اخْرُجْ عَلَيْهِنَّ فَلَمَّا رَأَيْنَهُ أَكْبَرْنَهُ وَقَطَّعْنَ أَيْدِيَهُنَّ وَقُلْنَ حَاشَ لِلَّهِ مَا هَذَا بَشَرًا إِنْ هَذَا إِلَّا مَلَكٌ كَرِيمٌ

﴿٣١﴾

“E kur ajo dëgjoji për ato pëshpëritjet e tyre, dërgoi t'i thërrasë ato, u përgatiti vend mbështetjeje dhe secilës prej tyre i dha nga një thikë e tha: ‘Dilu para atyre!’ Kur e panë atë, ato u tronditën dhe i prenë duart e tyre e thanë: ‘Allahut i qofshim falë! Ky nuk është njeri, ky nuk është tjetër vetëm se ndonjë engjëll i lartë!’” (Jusuf: 31)

Gruaja e Azizit thotë: “Unë ia arrita qëllimit për të treguar bukurinë e djaloshit: kjo është ajo për të cilën më keni mallkuar dhe më keni llogaritur fajtore.”

Pastaj,

ju ka thënë atyre: “Unë kam dashur ta përvetësoj për veten time, mirëpo ai ka refuzuar.

Ju ka thënë atyre: ‘Po që se nuk vepron për atë që e urdhëroj në një të ardhme të afërt, do ta dërgoj në burg dhe do të jetë prej të nënçmuarve dhe të poshtëruarve’.”

E paralajmëron Jusufin se do ta dënojë me burg.

Ky është fakt se dashuria ndaj tij e ka verbuar nga gjithçka.

Këtë ngjarje Zoti e tregon si në vijim:

Ajo tha:

قَالَتْ فَذَلِكُنَّ الَّذِي لُمْتُنَنِي فِيهِ ۖ وَلَقَدْ رَاودْتُهُ عَنْ نَفْسِهِ فَاسْتَعْصَمَ ۚ وَلَئِن لَّمْ يَفْعَلْ مَا آمُرُهُ لَيُسْجَنَنَّ

وَلَيَكُونَنَّ مِنَ الصَّاعِرِينَ ﴿٣٢﴾

“Qe, ky është ai për të cilin më qortuat mua, e unë e mësyna atë, po ai u ruajt fort. Po që se nuk e bën çka e urdhëroj, ai gjithqysh do të burgoset dhe do të nënçmohet.” (Jusuf: 32)

Përfundim

Jusufi thotë: “Zoti im, Ti je vendi ku mbështetem.

Zoti im, preferoj burgun të cilin po ma tregojnë e nuk e lejoj veten të nënshtrohem ndaj tyre.

Zoti im, për mua më i dashur është burgu sesa ajo çka kërkojnë këto gra; këto kërkojnë imoralitet dhe mëkate.

Zoti im, nëse Ti nuk më shpëton, do të shkatërrohem.

Zoti im, nëse nuk i largon kurthet dhe tradhtitë e tyre nga unë, do të anoj në anën e tyre dhe do të bëhem prej injorantëve mëkatarë.”

Ky është dorëzim te Allahu Famëlartë, mbështetje te Ai dhe ankesë te Allahu nga veprimet e grave. Lutje te Zoti për ta shpëtuar nga sprova. Zoti i Madhërishëm thotë:

Ai (Jusufi) tha:

قَالَ رَبِّ السِّجْنُ أَحَبُّ إِلَيَّ مِمَّا يَدْعُونَنِي إِلَيْهِ وَإِلَّا تَصْرِفْ عَنِّي كَيْدَهُنَّ أَصْبُ إِلَيْهِنَّ وَأَكُن مِّنَ الْجَاهِلِينَ ﴿٣٣﴾

“O Zoti im, burgu është më i dëshiruar për mua sesa ajo që më ofrojnë ato mua, dhe nëse Ti nuk ma largon prej meje dredhinë e tyre, unë mund të anoj te ato dhe të bëhem injorant.” (Jusuf: 33)

Zoti i tij i është përgjigjur pozitivisht dëshirës së tij.

Lutja e tij u bë realitet.

Zoti e largoi nga kurthet e tyre dhe nuk e lejoi të mëkatonte.

Allahu dëgjon lutjen e të sinqertëve të cilët mbështeten te Ai.

Allahu e di besimin e vërtetë të të sinqertëve, di për situatën e tyre dhe di se çka është më e mirë për ta.

Pas të gjitha atyre ngjarjeve u paraqit ideja te ata që ta burgosin për një afat të pacaktuar.

Mbretit dhe gruas së tij, pasi është përhapur lajmi dhe akuzimi për ta, iu paraqit ide e cila do të ishte në dobi të tyre.

Kjo ide u paraqit edhe pse u vërtetua pafajësia e Jusufit, pasi u paraqitën faktet në anën e drejtësisë së tij, edukatës së tij dhe pastërtisë së tij.

Kjo për të heshtur trazirat dhe për t'u lënë në harresë akuza për të cilën është njollosur gruaja e mbretit.

Kjo e mirë ishte përgatitje që Jusufi të kthehet qeveritar dhe administrator në Egjipt.

Allahu për zgjedh dhe vepron çka të dojë Ai.

Zoti i Madhërishëm thotë:

فَاسْتَجَابَ لَهُ رَبُّهُ فَصَرَفَ عَنْهُ كَيْدَهُمْ ۖ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٣٤﴾

ثُمَّ بَدَأَ لَهُمْ مِنْ بَعْدِ مَا رَأَوْا الْآيَاتِ لَيْسَجْنَةً حَتَّىٰ جَاءَ ﴿٣٥﴾

“E Zoti i tij ia pranoi lutjen atij dhe largoi nga ai dredhinë e tyre. Vërtet, Ai është që dëgjon (lutjet) dhe di (gjendjen). Mandej, pasi që vërtetuan argumentet (e pastërtisë së Jusufit), atyre (ministrit dhe rrethit të tij) iu paraqit ideja që ata për një kohë ta burgosin.” (Jusuf: 34, 35)

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe të tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim si muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcejell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E GJASHTË

HISTORIA E JUSUFIT ME SHOKËT E TIJ NË BURG

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat; kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje, nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne, me të shpallur të këtij Kur'ani, po të rrëfejme ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”.** (Jusuf, 3)

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Burgjet janë për kriminelët.

Në burgje vendosen kriminelët të cilët shkaktojnë trazira.

Ndonjëherë vendosen edhe të sinqertët, të drejtët dhe të mirët, pafajësisht.

Fatkeqësisht, kur burgosen të pafajshmit, të mirët përkrahës të tyre janë të paktë.

Kaq ka pasur sisteme të cilat i kanë burgosur të pafajshmit e pastaj kanë heshtur të tjerët, siç është rasti i Azizit, i cili e ka ditur pafajësinë e Jusufit, mirëpo ka heshtur. Pra, ka heshtur kur është burgosur i pafajshmi Jusufi a.s.

Edhe sot ka vende ku burgosen të pafajshmit, ndërsa heshtin të tjerët.

Në atë kohë sistemi funksiononte në parimin e të fuqishmit, jo të drejtësisë. Edhe sot ka sisteme të cilat i burgosin të pafajshmit, ndërsa nuk guxojnë t'i burgosin oligarkët dhe të fuqishmit.

Me çështjet me të cilat ballafaqohen pejgamberët, vështirë se mund të ketë raste të tilla në histori.

Kështu, Jusufi a.s. sprovohet me një sprovë tjetër. Jusufi përfundon në sfidat e burgjeve.

Ai ishte i pastër, i pafajshëm; ai është burgosur edhe pse nuk ishte i akuzuar [fajtor].

Mirëpo, ka shpëtuar nga lajkat dhe tradhtitë e grave.

وَعَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَعَسَىٰ أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ شَرٌّ لَّكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا

تَعْلَمُونَ ﴿٢١٦﴾

"Ndoshta njeriu e urren një send, por ajo është e dobishme për ju, ndonëse e urreni. Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju, e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini." (Bekare, 216)

Vëllezër të nderuar!

Në burg, të burgosurit ishin ken'anijunë dhe egjiptasë, të cilët besonin në shumë zota, si p.sh. në diell, në lopë dhe në firaunin.

Burgu ku qëndronte Jusufi ishte rast i mirë për t'i ftuar të burgosurit në adhurim vetëm ndaj Allahut.

Ishte rast i mirë për t'i ftuar të burgosurit që t'i largonin nga idhujtaria.

Për këtë arsye:

ka kërkuar prej të burgosurve që të përmirësohen;

ka kërkuar prej tyre që të bëhen të devotshëm;

u ka interpretuar ëndrrat të cilat i ëndërronin, e që më pastaj ëndrrat e tyre bëheshin realitet.

Kjo ka ndikuar që të burgosurit të kishin besim në të, ta donin dhe ta nderonin.

Në komunikim me të burgosurit, Jusufi u tregon se i takon fesë së gjyshërve pejgamberë: Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit.

Këtu i shohim katër gjenerata të pejgamberëve: gjyshi, djali, nipi dhe stërnipi, pra Ibrahim, Is'haku, Jakubi dhe Jusufi.

Jusufi i thërret që të besojnë vetëm në një Zot, pra në rend të parë të heqin dorë nga adhurimi i idhujve.

Zoti i Madhërishëm tregon se Jusufi a.s. ka thënë:

“Unë ndoqa fenë e prindërve të mi: Ibrahimit, Is’hakut, Jakubit. Neve nuk na takoi t’i përshkruajmë kurrë një send shok Allahut.”

Pastaj,

Jusufi e deklaroi programin e përgjithshëm të pejgamberëve, ku thotë: **“Pejgamberëve nuk ju takon që të adhurojmë shumë zota, qofshin zota nga lloji njeri, nga mbretërit ose xhinët.”**

Ky është deklarimi për Njeshmërinë e Allahut, se vetëm Allahu është Zot i paortak.

Kjo është begati e Allahut për ne, që nga momenti kur na ka udhëzuar në atë drejtim.

Begati tjetër e Allahut është se ka dërguar pejgamberë për njerëzit, që t’i orientojnë, t’i udhëzojnë në rrugën e drejtë dhe t’i largojnë nga rruga e devijuar, mirëpo shumica e njerëzve nuk falënderojnë për të mirat e Allahut dhe begatitë e Tij, por i përshkruajnë Allahut ortak dhe nuk e vlerësojnë begatinë e dërgimit të pejgamberëve për ta. Zoti i Madhërishëm tregon se Jusufi a.s. ka thënë:

وَاتَّبَعْتُ مِلَّةَ آبَائِي إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ ۚ مَا كَانَ لَنَا أَنْ نُشْرِكَ بِاللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ۚ ذَلِكَ مِنْ فَضْلِ
اللَّهِ عَلَيْنَا وَعَلَى النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَشْكُرُونَ ﴿٣٨﴾

“Ky (besim i drejtë) është dhuratë e madhe nga Allahu ndaj nesh dhe ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk ia dinë vlerën.” (Jusuf: 38)

Të drejtë janë pejgamberët dhe të mirët të cilët insistojnë në Njeshmërinë e Allahut dhe adhurimin ndaj Tij.

Të drejtë janë pejgamberët dhe të mirët të cilët zbatojnë programin e Zotit, si në adhurim, në raportet ndërnjerëzore, ashtu edhe në vlerat morale.

Kështu pra, edhe duhet të jemi falënderues ndaj Allahut që na ka bërë muslimanë.

Vëllezër të nderuar!

Tani, të shohim historinë e Jusufit me shokët e tij në burg.

Duke komunikuar me dy të burgosurit, Jusufi ka parashtruar pyetje logjike:

Çka është më e dobishme: thënia se ka shumë zota dhe besimi në zota të ndryshëm, apo besimi në Allahun, Një Zot të Vetëm, i Cili është Mbizotërues dhe Triumfues?

Çka është më e mirë: thënia se ka shumë zota dhe besimi në zota me atribute të ndryshme, apo besimi në Allahun, Një Zot të Vetëm, i Cili nuk ka nevojë për zot tjetër, i Cili në vullnetin e Tij dhe me fuqinë e Tij e mposht çdo gjë?

Mirëpo,

shumica e njerëzve nuk e dinë këtë fe të vërtetë, e cila nuk ka devijime.

Ky është shkaku se shumica e tyre janë idhujtarë, siç thotë Allahu i Madhërishëm:

وَمَا أَكْثَرُ النَّاسِ وَلَوْ حَرَصْتَ بِمُؤْمِنِينَ ﴿١٠٣﴾

“Po ti, edhe pse lakmon (për besimin e tyre), shumica e njerëzve nuk do të besojnë.” (Jusuf, 103)

Pastaj, Jusufi a.s. u thotë:

“Nuk ju vjen juve ndonjë ushqim me të cilin ushqeheni, e që unë të mos e di, t’ju përshkruaj atë para se t’ju vijë. Kjo është nga ajo çka më mësoi Zoti im.”

U ka thënë: "Për çdo ditë, para se t'ju afrohet ushqimi, unë ju tregoj se çfarë ushqimi do t'ju ofrohet. Kjo është prej diturisë së Allahut, i cili më mëson mua, dhe nuk është çështje e fallit, e parashikimit iluzionar apo e magjistarëve."

Vëllezër të nderuar!

Jusufi a.s. ka interpretuar ëndrra të shumta në burg, por prej interpretimeve më të njohura janë:

- interpretimi i ëndrrës së dy shokëve në burg;
- interpretimi i ëndrrës së mbretit.

Sa i përket dy shokëve të burgut:

Njëri ishte bukëpjekës, ndërsa tjetri ishte kamarier. (Ndoshta këto dy profesione ishin prej profesioneve më të nevojshme të asaj kohe).

Bukëpjekësi dhe kamarieri kishin parë ëndërr.

Kamarieri thotë: "Kam ëndërruar se si e shtrydh rrushin dhe prodhoj alkool".

Bukëpjekësi thotë: "Kam ëndërruar duke bartur bukë mbi kokën time, dhe shpendët ushqeheshin prej asaj buke të vendosur mbi kokën time".

E pyesin Jusufin: "A ke mundësi të na interpretosh ëndrrat tona, dhe a mund të bëhen realitet? Ne veç e dimë se ti je njeri i cili i interpreton ëndrrat më së miri." Zoti i Madhërishëm tregon se:

وَدَخَلَ مَعَهُ السَّجْنَ فَتَيَانٍ ۖ قَالَ أَحَدُهُمَا إِنِّي أَرَانِي أَعْصِرُ خَمْرًا ۖ وَقَالَ الْآخَرُ إِنِّي أَرَانِي أُحْمَلُ فَوْقَ
رَأْسِي خُبْرًا تَأْكُلُ الطَّيْرُ مِنْهُ ۖ نَبِّئْنَا بِتَأْوِيلِهِ ۖ إِنَّا نَرَاكَ مِنَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٣٦﴾

"Njëri prej atyre dyve tha: 'Unë ëndërrova veten se po shtrydhi (rrush për) verë'. E tjetri tha: 'Unë ëndërrova se po bart mbi kokë një bukë, nga e cila hanin shpezët. Na trego komentin e saj, se ne të konsiderojmë nga komentuesit e mirë (të ëndrrave).'" (Jusuf: 36)

Kamarierit, i cili kishte ëndërruar duke shtrydhur rrush nga i cili prodhohej alkooli, i thotë: "Ashtu siç i the shërbyer mbretit më parë, ti do t'i shërbesh atij me pije, ashtu siç e kërkon zakoni".

Ky ka qenë fakt i pafajësisë së tij se nuk ka bashkëpunuar me të akuzuarit në tentativën për ta helmuar mbretin.

Sa i përket të dytit: Ai ka qenë bukëpjekës, i cili barte mbi kokën e tij bukë, mbi të cilën ushqeheshin shpendët (pra do ta hanë shpendët, siç është shqiponja), do të thotë se ai do të dënohet që nga koka e tij – do të vritet e që më pastaj do të kryqëzohet i vdekur. Jusufi u thotë:

يَا صَاحِبِ السِّجْنِ أَمَّا أَحَدُكُمَا فَيَسْقِي رَبَّهُ خَمْرًا ۖ وَأَمَّا الْآخَرُ فَيُصْلَبُ فَتَأْكُلُ الطَّيْرُ مِنْ رَأْسِهِ ۚ
قُضِيَ الْأَمْرُ الَّذِي فِيهِ تَسْتَفْتِيَانِ ﴿٤١﴾

“O shokët e mi të burgut! Njëri prej ju dyve do t'i japë për të pirë verë zotërisë të vet, e tjetri do të varet, kurse shpezët do të hanë nga koka e tij. Çështja për të cilën kërkuat shpjegim ka marrë fund (kështu).” (Jusuf: 41)

Vëllezër të nderuar!

Kamarierit, për të cilin ishte i bindur se do të shpëtonte, fshehurazi – duke mos ia bërë me dije tjetrit – i thotë: “Çështjen time tregoj zotërisë tënd, pra mbretit, se ndoshta do të më lirojë nga burgu pasi do ta vërtetoni pafajësinë time.”

Kjo është prej formave se si duhet pasuar shkaqet, dhe zakonisht bëhet kërkesa për të vërtetuar pafajësinë, për të shpëtuar dhe për t'u liruar nga burgu. Zoti i Madhërishëm tregon se:

وَقَالَ لِلَّذِي ظَنَّ أَنَّهُ نَاجٍ مِّنْهُمَا اذْكُرْنِي عِنْدَ رَبِّكَ فَأَنَسَاهُ الشَّيْطَانُ ذِكْرَ رَبِّهِ فَلَبِثَ فِي السِّجْنِ بِضْعَ
سِنِينَ ﴿٤٢﴾

“E atij për të cilin besonte se është i shpëtuar i tha: ‘Më përkujto mua te zotëria yt’. Po djali e vuri në harresë ta përkujtonte te zotëria i tij, e për këtë mbeti në burg disa vjet.” (Jusuf: 42)

Mirëpo,

shejtani bën që ai të harrojë për t'ia treguar çështjen e Jusufit, që pejgamberi i Allahut, Jusufi, të mos dalë nga burgu, e që pastaj t'i thërrasë të tjerët për të besuar Allahun në Njëshmërinë e Tij.

Shejtani angazhohet t'i largojë njerëzit që të mos i kuptojnë cytjet e tij.

Përfundim

Jusufi ka mbetur i harruar në burg edhe për shtatë vite, pra nga tri deri në nëntë vite.

Jusufi ka mbetur në burg shtatë vite, dhe prej Allahut është dënuar edhe për pesë vite të tjera. Kohëzgjatja në burg gjithsej ka qenë dymbëdhjetë vite.

Pesë vite pas shtatë viteve, si dënim prej Allahut, për shkak se kamarierit personal i kishte thënë: “Përkujtoja këtë çështje zotërisë tënd”, kështu që i kishin kaluar në burg dymbëdhjetë vite.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe të tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E SHTATË

INTERPRETIMI I ËNDRRËS SË MBRETIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat; kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje, nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne, me të shpallur të këtij Kur'ani, po të rrëfejme ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”.** (Jusuf, 3)

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Mbreti i Egjiptit e kishte parë një ëndërr.

Ka kërkuar interpretimin e saj.

Përmbajtja e ëndrrës ishte si në vijim:

Nga shtrati i lumit të shterur kishin dalë shtatë lopë të majme dhe i kishin ngrënë shtatë lopë të tjera të dobëta.

Pastaj:

Shtatë kallinj të njomë që kishin kokrra kishin mundur shtatë kallinj të thatë, të cilëve u kishte ardhur koha e korrjes dhe ishin shterur. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَقَالَ الْمَلِكُ إِنِّي أَرَى سَبْعَ بَقَرَاتٍ سِمَانٍ يَأْكُلُهُنَّ سَبْعٌ عِجَافٌ وَسَبْعَ سُنبُلَاتٍ خُضْرٍ وَأُخَرَ يَابِسَاتٍ ۚ
يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ أَفْتُونِي فِي رُؤْيَايَ إِن كُنْتُمْ لِلرُّؤْيَا تَعْبُرُونَ ﴿٤٣﴾

“E (kur u afrua lirimi i Jusufit) mbreti tha: ‘Kam parë ëndërr shtatë lopë të majme dhe shtatë lopë të dobëta që i hanin ato (të dobëtat, i gëlltitën ato të majmet), dhe shtatë kallinj të gjelbër (që kishin lidhur frytin) e (shtatë) të tjerë të thatë. O ju pari, nëse dini të interpretoni ëndrrën, më tregoni për ëndrrën time!’” (Jusuf: 43)

Të nesërmen:

Mbreti i thërret falltarët dhe u thotë: “Më interpretoni këto ëndrra!”

I thërret edhe dijetarët dhe u thotë: “Më sqaroni qëllimin e atyre ëndrrave!”

Ata i thonë: “Ato nuk janë asgjë tjetër pos halucinacione dhe imagjinatë të cilën e sheh i fjeturi në mendjen e tij.”

Ata i thonë: “Nuk kanë kurrfarë kuptimi, por edhe nëse janë të vërteta, ne nuk kemi njohuri t'i interpretojmë ëndrrat e tilla.”

Ata (paria) thanë:

قَالُوا أَضْغَاتٌ أَحْلَامٍ ۚ وَمَا نَحْنُ بِتَأْوِيلِ الْأَحْلَامِ بِعَالَمِينَ ﴿٤٤﴾

“Ëndrra të përziera, e ne nuk dimë komentin e ëndrrave të tilla.” (Jusuf: 44)

Shërbyesi i mbretit – ai i cili kishte shpëtuar nga vdekja, i cili kishte qenë shok i Jusufit në burg – e kujton, pasi veç e kishte harruar, dhe i thotë

mbretit e parisë mbretërore: “Unë ju tregoj interpretimin e kësaj ëndrre, por më parë më dërgoni te Jusufi, i drejti dhe i sinqerti, i cili për momentin është në burg.”

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَقَالَ الَّذِي نَجَا مِنْهُمَا وَادَّكَرَ بَعْدَ أُمَّةٍ أَنَا أُنَبِّئُكُمْ بِتَأْوِيلِهِ فَأَرْسِلُونِ ﴿٤٥﴾

“E ai prej atyre dyve që shpëtoi (që i pat thënë Jusufi ta përmendë) e përkujtoi pas një periudhe e tha: ‘Unë ju tregoj kuptimin e saj. Pra, më lejoni të shkoj (te Jusufi).’” (Jusuf: 45)

E lejojnë të shkojë për vizitë në burg te Jusufi a.s.

Shkon, e viziton dhe i thotë Jusufit a.s.: “O Jusuf, o njeri fisnik! A ka mundësi të përgjigjesh për ëndrrën e mbretit, e ndoshta pastaj Allahu të liron nga burgu?”

O Jusuf, i drejti i gjithë botës, i specializuar në interpretimin e ëndrrave: a ka mundësi të përgjigjesh për ëndrrën e mbretit, e ndoshta pastaj Allahu të liron nga burgu?

Pastaj ia tregon ngjarjen se shtatë lopë të dobëta do t'i hanë shtatë lopë të majme, dhe shtatë kallinj të dobët do t'i hanë shtatë kallinj të tjerë të njomë.

Pastaj i thotë se ai do të kthehet te njerëzit dhe do t'ua mësojë të vërtetën e cila rezulton nga ajo ëndërr.

Vëllezër të nderuar!

Jusufi nuk e qorton dhe nuk e kritikon.

Jusufi nuk e kushtëzon me daljen nga burgu, por i përgjigjet se:

Do të vijojnë shtatë vite njëra pas tjetrës ku do të ketë të korrura dhe të lashta të bollshme; çka të korrni, lërinë në kallinj, ashtu që të mos i hanë krimbat, përpos një pjese e cila është e domosdoshme për t'u konsumuar. Këto janë shtatë vite në të cilat llogariten lopët e majme dhe kallinj të njomë.

Pastaj, pas këtyre shtatë viteve do të pasojnë shtatë vite me thatësi, ku qytetarët do të shfrytëzojnë rezervat e shtatë viteve, përpos asaj çka e kanë shpenzuar.

Pastaj, pas katërmëdhjetë viteve do të bjerë prapë shi, do të ketë të lashta dhe të korrura të mjaftueshme, dhe njerëzit do të prodhojnë vaj ulliri, lëngje pemësh, rrushi, hurmash e të ngjashme.

Këto informacione të panjohura për të ardhmen janë shpallje dhe inspirim prej Allahut, nuk janë thjesht vetëm interpretim ëndrrash për përgëzim për vitin pas pesëmbëdhjetë viteve të interpretimit të ëndrrës, ku do të jetë vit i bekuar dhe i begatshëm, me shumë të mira.

Ky ka qenë informim nga shpallja qiellore.

Kjo rezulton vetëm nga peygamberi apo nga i dërguari.

Ky ka qenë informim se peygamberia do të jetë e mira madhështore për njerëzimin.

Ky ka qenë informim se e mira madhështore është në fe dhe për të mirën e jetës së kësaj bote.

Vëllezër të nderuar!

Jusufi ka mbetur në burg shtatë vite, dhe prej Allahut është dënuar edhe për pesë vite të tjera. Kohëzgjatja në burg gjithsej ka qenë dymbëdhjetë vite.

Pesë vite pas shtatë viteve, si dënim prej Allahut, për shkak se kamarierit personal të mbretit i kishte thënë: “Përkujtoja këtë çështje zotërisë tënd”, kështu që i kishin kaluar në burg dymbëdhjetë vite.

Pas shpalosjes së qëllimit të ëndrrës së mbretit të Egjiptit, ka qenë e natyrshme që të mençurit të kërkojnë nga mbreti që të takohen me Jusufin në burg, i cili ka qenë në gjendje të interpretojë atë ëndërr.

Ka qenë e logjikshme që të mençurit të kërkojnë nga mbreti që të takohen me Jusufin në burg, i cili e ka interpretuar atë ëndërr.

Kjo kërkesë tregon për vlerën e diturisë.

Kjo kërkesë tregon pozitën e lartë të dijetarëve, nga të cilët kërkohet këshillë për çështje të rëndësishme.

Për çështje të rëndësishme kërkoni këshillë nga dijetarët.

Përballë kësaj kërkesë, Jusufi a.s. paraqet çështjen e rishqyrtimit të lëndës nëpërmjet të cilit është akuzuar nga gruaja e Azizit, dhe shkakun se pse është futur në burg.

Pastaj mbreti ka kërkuar që të takohet me Jusufin a.s.

Jusufi a.s. e ka refuzuar atë kërkesë, ka dashur që të shpallet pafajësia e tij.

Ka dashur që të shpallet ndershmëria e tij dhe se i është bërë padrejtësi për shtatë vite, e që më pastaj kanë pasuar edhe pesë vite të tjera.

Jusufi a.s. nuk e ka pranuar ftesën e të deleguarit që të dalë nga burgu dhe të prezantohet në pallatin mbretëror, por i ka thënë: “Shko te zotëria yt dhe pyete për çështjen e grave të cilat i kanë lënduar duart e tyre, sepse unë nuk dëshiroj të prezantohem për atë çështje; unë jam i akuzuar dhe jam burgosur për atë çështje. Kërko nga mbreti që ta vërtetojnë dhe ta zgjidhin çështjen para se të jem prezent aty, që ta kuptojë të vërtetën e çështjes. Zoti im Famëlartë i di çështjet e fshehta.”

Allahu i di kurthet dhe planifikimet e grave për t'i ngritur kurth Jusufit a.s. Andaj, Jusufi ka kërkuar që të rishqyrtohet lënda e grave të cilat i kanë prerë duart e tyre dhe që të vërtetohet e vërteta e asaj çështjeje.

Vëllezër të nderuar!

Mbreti ka kërkuar që ta sjellin Jusufin a.s. nga burgu, derisa të vërtetohet prej tij singëriteti i asaj se çfarë në të vërtetë sinjalizon ëndrra, sepse ndryshe është vetëm të jepet lajmi, e ndryshe është prezantimi konkret i lajmëtarit.

Mbreti i tubon gratë të cilat i kishin prerë duart te gruaja e Azizit.

Fillon seanca gjyqësore.

Të gjithave atyre u drejtohet, mirëpo qëllimi ka qenë te gruaja e Azizit, e cila ishte gruaja e ministrit të parë: “Çka është çështja juaj me Jusufin të cilin e keni ngacmuar në ditën festive?”

Ato kanë thënë: “Zoti na ruajttë!

Jusufi nuk ka bërë asgjë të keqe,
ne nuk e kemi akuzuar për asgjë.

Për Zotin, ne nuk dimë se ka bërë të keqe gjatë gjithë kohës.”

Zulejhaja, gruaja e Azizit, e pranon të vërtetën dhe realitetin i cili ka buruar prej saj, e pranon këtë vlerë dhe e deklaron haptazi fajësinë e saj.

Kjo ka qenë edhe kërkimfalje edhe arsyetim, se zakonisht njerëzit mund të mëkatojnë për shkak të epshit.

Gruaja e Azizit të Egjiptit, para mbretit, me fjalët e saj dëshmoi dhe pranoi gjendjen e saj.

Me fjalët e saj ajo sqaroi dobësinë e njeriut dhe mundësinë për të bërë gabime, duke thënë: “Edhe pse tregova pafajësinë e Jusufit, nuk e shfajësoj veten time se kam lajthitur dhe kam rrëshqitur në mëkate.”

Pa dyshim se Zoti im i fal mëkatet.

Pa dyshim se Zoti im është i Mëshirshëm ndaj atyre të cilët mëkatojnë, por pastaj pendohen dhe kthehen te Allahu.

وَمَا أُبْرِئُ نَفْسِي ۚ إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي ۚ إِنَّ رَبِّي غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٥٣﴾

“Unë nuk e shfajësoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që e ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im është që fal e mëshiron shumë.” (Jusuf: 53)

Atëherë gruaja e Azizit ka thënë:

“Tani doli e vërteta në shesh, pasi ishte e fshehur;

unë kam dashur që Jusufin ta përvetësoj për veten time, ndërsa ai ka refuzuar,

është mbyllur dhe është mbrojtur.

Ai është i drejtë në atë që e thotë, ai kurrë nuk gënjen.”

Ky është fjalimi i gruas së Azizit.

Parim themeloresh është se:

Allahu nuk qëndron në anën e veprës së tradhtarit.

Nuk e plotëson dhe nuk e mundëson që të bëhet e suksesshme. Zoti i Madhërishëm tregon se

“...Allahu nuk lejon që të jenë të suksesshme grackat e tradhtarëve.”

Ky është motivim për të dobëtit dhe ndaj atyre të cilëve u bëhet padrejtësi.

Ky është motivim ndaj atyre të cilët Allahu i mbron dhe u ndihmon, dhe në fund i siguron nga e keqja, siç figuron në ajetin tjetër:

إِنَّ اللَّهَ يُدَافِعُ عَنِ الَّذِينَ آمَنُوا ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ خَوَّانٍ كَفُورٍ ﴿٣٨﴾

“Allahu largon dëmet e idhujtarëve ndaj atyre që besuan, se Allahu nuk e do asnjë tradhtar e bukëpërmbysët.” (el-Haxh, 38)

Përfundim

Mbretit i bëhet e qartë pafajësia e Jusufit dhe ndershmëria e tij.

I bëhet i qartë burgosja e tij me padrejtësi.

Dëshmohet edhe besnikëria e Jusufit.

I bëhet i qartë durimi i tij.

I bëhet i qartë stoicizmi i tij.

Është bindur në dashamirësinë e tij.

Është bindur në veprimet e mira të tij.

Pasi komunikon me Jusufin,

e vërteton profesionalizimin e tij,

e vërteton aftësinë e tij,

e vërteton vlerën dhe diturinë e tij.

Mbreti e vërteton edukatën dhe moralin e tij, dhe i thotë: “Sot ti te ne ke pozitë të lartë dhe respekt të veçantë, ke besë dhe nder të veçantë, ne të besojmë gjithçka si në çështje të gjykimit, ashtu edhe në çështje ekonomike dhe administrative.”

Jusufo i thotë mbretit: “O mbret, më emëro të jem përgjegjës i depove shtetërore, në të cilat grumbullohen gjërat ushqimore!

Më bëj menaxher që t'i menaxhoj dhe t'i sistemoj gjërat ushqimore, ashtu që t'i shpëtoj vendet nga mungesa e ushqimit, e cila mungesë do t'i kërcënojë ata. Unë jam kujdestar i drejtë dhe besnik, kam njohuri dhe vizion për këtë detyrë.”

Ky është argument se lejohet të kërkohet e drejta për punë dhe punësim.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe të tokës, Ti je ndihmëtar i ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E TETË

JUSUFI MINISTËR I FINANCAVE

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat; kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje, nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore, të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne, me të shpallur të këtij Kur'ani, po të rrëfejme ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”.** (Jusuf, 3)

Dhe e përfundon suren Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Jusufi dëshironte që të mbizotëronte drejtësia dhe t'i stabilizonte vendet e rajonit.

Ministritë dhe qeveritë e shteteve e kanë për detyrë të sigurojnë stabilitetin rajonal.

Jusufi dëshironte t'i shpëtonte nga varfëria vendet e rajonit.

Obligimi i shtetit duhet të jetë luftimi i varfërisë dhe papunësisë.

Jusufi dëshironte t'i shpëtonte nga mungesa e elementeve ushqimore.

Qeveritë duhet të sigurojnë rezerva shtetërore të produkteve elementare ushqimore.

Për këtë arsye ka dashur të bëhej ministër i ekonomisë dhe financave.

Jusufi a.s. i ka thënë mbretit: “O mbret, më emëro të jem përgjegjës i depove shtetërore! Më emëro përgjegjës të grumbullimit të gjërave ushqimore.”

Mbreti e pranon kërkesën e tij dhe e emëron ministër të ekonomisë dhe financave. Ia beson çështjet e arkës financiare të Egjiptit.

Mbreti i jep të drejtë në menaxhim dhe në çështjet gjyqësore, pasi e ka vërtetuar se posedon urtësi, ka eksperiencë, vizion dhe drejtësi në menaxhim.

Duke sqaruar këtë gjendje, Allahu i Madhërishëm thotë:

Mbreti tha:

وَقَالَ الْمَلِكُ ائْتُونِي بِهِ اَسْتَخْلِصْهُ لِنَفْسِي فَلَمَّا كَلَّمَهُ قَالَ اِنَّكَ الْيَوْمَ لَدَيْنَا مَكِينٌ اَمِينٌ ﴿٥٤﴾

“Më sillni mua atë, thjesht ta veçoj për veten time!” (ia sollën Jusufin) E pasi bisedoi me të, tha: “Tash ti ke pozitë dhe je i besueshëm.” (Jusuf: 54)

Ky është argument i urtësisë, mençurisë dhe drejtësisë.

Kjo ka qenë përgatitje e ngritjes së Jusufit në pozita më të larta, dhe që të realizohet qëllimi i Allahut të Lartmadhërishëm për t'i nënshtruar vëllezërit e Jusufit, dhe që ata të kenë nevojë për të, ku Zoti i Madhërishëm tregon dhe thotë:

Ai (Jusufi) tha:

قَالَ اجْعَلْنِي عَلَى خَزَائِنِ الْأَرْضِ إِنِّي حَفِيظٌ عَلَيْمُ ﴿٥٥﴾

“Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm.” (Jusuf: 55)

Vëllezër të nderuar!

Është realizuar dhe realizohet urdhri i Allahut.

Është realizuar dhe realizohet qëllimi, përcaktimi i Allahut.

Është realizuar dhe realizohet dëshira e Allahut.

Zoti i Madhërishëm në Kur'an sqaron veprimin e mirë të Tij ndaj peygamberit të Tij, Jusufit a.s.

Zoti i Madhërishëm në Kur'an sqaron veprimin e mirë të Tij ndaj robërve të Tij.

Me këto begati e ka begatuar Allahu Jusufin që të përvetësojë zemrën e mbretit, dhe për të shpëtuar nga burgu.

Allahu cakton çfarë të dëshirojë:

E ka caktuar që të fitojë pozitë të lartë në tokën e Egjiptit.

E ka caktuar që nga pozita e skllavërisë të kalojë në pozitën qeveritare.

E ka caktuar që nga pozita e skllavërisë të kalojë në pozitën e lartë shtetërore.

E ka caktuar që nga pozita e skllavërisë të kalojë në pozitën e zbatimit të politikave programore shtetërore.

E ka caktuar që nga pozita e skllavërisë të kalojë në pozitën që të stabilizojë shtetin e Egjiptit dhe ta avancojë drejt zhvillimit.

Allahu Famëlartë, me mëshirën e Tij, me mirësinë e Tij dhe me begatitë e Tij përfshin cilin do prej robërve të Tij. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ يَتَّبِعُوا مِنْهَا حَيْثُ يَشَاءُ نُصِيبُ بِرَحْمَتِنَا مَنْ نَشَاءُ

“Dhe kështu Ne Jusufit i dhamë pozitë në vend (në Egjipt), zinte vend aty ku dëshironte. Ne e pajisim me të mira tona atë që duam.” (Jusuf: 56)

Allahu Famëlartë nuk ua humb shpërblimin as në këtë botë, as për botën tjetër atyre të cilët veprojnë punë të mira.

Vetëm se shpërblimi i të devotshmëve në botën tjetër do të jetë se ata do të fitojnë Xhenetin e përhershëm, e shpërblimi i Xhenetit është më i mirë dhe më madhështor se të mirat e kësaj bote, siç janë pushteti dhe qeverisja, pasuria dhe komoditeti. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَلَا نُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٥٦﴾

“...dhe Ne nuk ua humbim shpërblimin punëmirëve.” (Jusuf: 56)

Përfundim

Ajo çka ka përgatitur Allahu për pejgamberin e Tij, Jusufin a.s., për në botën tjetër është më madhështore se ajo me çka e ka begatuar në këtë botë.

Atij të cilit Allahu i jep dy lumturitë, lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër, ajo është begati e Allahut edhe më e madhe, dhe më e plotë.

Kjo për të qenë i devotshëm, dhe për t'u larguar nga mëkatet.

Kjo dëshmon se njeriu shpërblehet në bazë të veprave të tij, dhe në bazë të devotshmërisë, dhe se nuk mund t'i zhvleftësohet nga Allahu, vetëm se...

Më e mira është shpërblimi në botën tjetër.

Bota tjetër duhet të jetë qëllim dhe pikësynim kryesor. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَلَا جُزْءَ الْآخِرَةِ خَيْرٌ لِلَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿٥٧﴾

“Po shpërblimi i botës tjetër gjithsesi është shumë më i mirë për ata që besuan dhe ata që u frikësuan dhe u ruajtën.” (Jusuf: 57)

Pozita e Jusufit në botën tjetër është më e mirë se pozita e nivelit të lartë në këtë botë.

E gjithë kjo sigurohet me besim të sinqertë, devotshmëri dhe stoicizëm.

Besimi është kriter bazë për t'u pranuar vepra.

Devotshmëria është kriter i vërtetësisë dhe fryt i besimit.

Stoicizmi është argument i pjekurisë, mençurisë dhe urtësisë.

Andaj, bëhu besimtar i sinqertë, i devotshëm dhe stoik!

Besimi, bindja e shëndoshë dhe devotshmëria ndaj Allahut sjellin lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Largimi nga ndalesat, kryerja e obligimeve dhe qëndrueshmëria në të gjitha këto sjellin lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Besimi, bindja e shëndoshë dhe devotshmëria ndaj Allahut sjellin të mirat e Allahut, drejtësinë e Tij, dhe mirësinë e Tij për çdo gjë, te çdo rob i Tij.

Allahu ka edhe të mira shtesë, të cilat janë posaçërisht për dashamirët e Allahut, zemrat e të cilëve mbushen me frikërespekt ndaj Allahut, dhe fitojnë kënaqësinë e Allahut për t'u pranuar veprat dhe sigurohen nga

momentet e devijimit dhe të neglizhimit, duke vazhduar drejt këtij programi të mirë.

Nuk është befasuese që Allahu disa prej robërve të Tij t'u përgatitë mundësi qeverisjeje në këtë botë, pas një poshtërimi dhe nënçmimi, e pastaj t'u mundësojë shfrytëzimin e të mirave të Allahut, të cilat në botën tjetër nuk ndërpriten asnjëherë dhe fitojnë lumturi në të dy botët.

Kjo është begatia madhështore.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe të tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E NËNTË

FËMIJËT E JAKUBIT SHKOJNË NË EGJIPT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për argëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe por për mësim dhe përfitime. Duhet ti lexojmë tregimet kur'anore të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojnë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne me të shpallur të këtij Kur'ani po të rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”.** (Jusuf, 3)

Dhe përfundon suren Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** (Jusuf, 111)

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Jusufi a.s. ishte ministër i ekonomisë.

Ai punonte me përkushtim të jashtëzakonshëm.

Për çdo vjet të korrurat që i mblidhte i ruante në magazina për kohë të vështira.

Shtatë vite rresht, të korrurat që i mblidhte i ruante në magazina për kohë të vështira.

Ai kishte paralajmëruar se mungesa e ushqimit do t'i përfshijë të gjitha vendet, e në mesin e tyre edhe vendin e Jakubit, i cili banonte në tokën e Palestinës, në luginat e Shamit.

Pas kohëve të mira ka filluar thatësi e madhe. Në shtatëvjeçarin e dytë përfshihet thatësia dhe varfëria, jo vetëm në Egjipt por edhe në Siri.

Ishte përhapur lajmi se mbreti i Egjiptit tregton me mallra ushqimore.

Fëmijët e Jakubit, jetonin në Palestinë. Në Palestinë, aty ku ishin vëllezërit e Jusufit a.s. kishte mungesë të ushqimit.

Djemtë e Jakubit, me fjalë tjera vëllezërit e Jusufit e kishin të domosdoshme që të drejtoheshin për në Egjipt për të blerë grurë dhe produkte tjera ushqimore.

Udhëtojnë për në Egjipt që të realizohet takimi në mes Jusufit dhe vëllezërve të tij.

Vëllezër të nderuar!

Kur hyjnë në shtetin e Egjiptit, mëkëmbësi i Egjiptit i pret me mirësi.

Mëkëmbësi i Egjiptit i pret në nivel të lartë shtetëror.

Jusufi kur i sheh i njeh, sepse forma e të mëdhenjve nuk ndryshon shumë, ndërsa,

vëllezërit e Jusufit nuk e njohin. Kjo nga shkaku se ata janë ndarë me të kur Jusufi ishte shumë i vogël, dhe ishte shitur nga një karvan kalimtar i udhëtarëve.

Me zhvillimin e fëmijës forma dhe pamja e fëmijës ndryshon shumë.

Përpos kësaj,

Ata kanë menduar se ai ka vdekur dhe, as që ju ka shkuar ndërmend se Jusufi mund të arrij atë pozitë të lartë.

Duke përshkruar këtë takim Allahu i Madhërishëm thotë:

وَجَاءَ إِخْوَةُ يُوسُفَ فَدَخَلُوا عَلَيْهِ فَعَرَفَهُمْ وَهُمْ لَهُ مُنْكَرُونَ ﴿٥٨﴾

“Dhe (pas një kohe) vijnë vëllezërit e Jusufit e hyjnë te ai, e ai i njohu, ndërsa ata nuk e njohnin.” (Jusuf, 58)

Kjo vërteton çështjen se vëllezërit nuk e kanë njohur Jusufin.

Biseda e cila u zhvillua në mes të Jusufit dhe vëllezërve të tij, ishte shkaku i shkuarjes së tyre dhe se ata kishin shkuar për të blerë produkte ushqimore, pastaj i pyet për vendin e tyre, për familjen e tyre, për babën e tyre dhe për të gjithë fëmijët e tij.

Kur shkuan te depot e ushqimit, Jusufi a.s. i pyeti sa vëllezër jeni?

Ata i përgjigjen:

- Ne jemi njëmbëdhjetë vëllezër.

Jusufi a.s. u thotë:

- Po ku është i njëmbëdhjeti, ju këtu jeni dhjetë.

Ata thanë:

- Kemi një vëlla të vogël, mirëpo babai frikohet për të dhe nuk e ka lejuar të vijë me ne.

Pastaj,

Ata i tregojnë se ishin dymbëdhjetë fëmijë njëri prej tyre ishte zhdukur në shkretëtirë ndërsa vëllai tjetër kishte qëndruar me babën që të përkujdesej për nevojat familjare.

Vëllezër të nderuar!

Jusufi urdhëron që të nderohen me nderime të veçanta dhe që të respektohen në mënyrë madhështore.

Kur e bën ngarkesën e tyre, e ngarkon grurin në dhjetë ngarkesa, i shton edhe dy ngarkesa shtesë për vëllanë dhe babën e tyre dhe ju thotë: Kur të vini herën tjetër merreni me vete vëllanë prej babe, Benjaminin.

A nuk po e shihni se unë i plotësoj ngarkesat e plota, pa lënë mangët asgjë, bile edhe ju ngarkoj me ngarkesa shtesë. Unë jam mikpritësi më i mirë i musafirëve.

Pastaj u ka thënë se nëse nuk e sjellin vëllanë e tyre Benjamin, kur të shkonin herën tjetër, nuk do të ketë mall ushqimorë për ta dhe se nuk do të ju lejohej të hynin në qytet.

Atë vit, Jusufi a.s. ua ka plotësuar njerëzve ushqimin (ngarkesat) por në të njëjtën kohë, ka vendosur në ngarkesat e tyre edhe mjetet materiale të tyre dhe nuk ka mbet asnjë fermer pa mallra ushqimore.

Kjo ka qenë e qartë se atë që ka vepruar Jusufi me vëllezërit e tij, ka qenë shpallje prej Allahut, sepse, përndryshe mirësia ndaj Jakubit do të nënkuptohej shumë lehtë, mirëpo Allahu i Madhërishëm e ka ditë si të vepron, që të plotëson shpërblimin e Jakubit dhe çështjen e Tij ashtu që t'i bëhet e qartë shkaku se pse e ka dashur Jusufin, dhe të interpretohet ëndrra e parë e tij, kur i kanë bërë sexhde njëmbëdhjetë yje.

Zoti i Madhërishëm tregon se Jusufi i ka thënë punëtorit të tij:

وَقَالَ لِفَتْيَانِهِ اجْعَلُوا بِضَاعَتَهُمْ فِي رِحَالِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَعْرِفُونَهَا إِذَا انْقَلَبُوا إِلَى أَهْلِهِمْ لَعَلَّهُمْ
يَرْجِعُونَ ﴿٦٢﴾

“Vënie mallin e tyre (barrën që e kishin sjellë për të blerë drithë) në barrët e tyre, ashtu që kur të kthehen te familja e tyre (t’i hapin barrët) ta njohin, e ndoshta do të kthehen sërish te ne”. (Jusuf, 62)

Në barrën e blerjes së ushqimit, vendose mallin e tyre, (pra çmimin e këmbyer) në barrën e tyre ashtu që të mos e hetojnë, sepse kur të shkojnë te familjet e tyre, do ta kuptojnë se i kemi nderuar dhe i kemi respektuar dhe do të lakmojnë për të ardhur përsëri, dhe gjithsesi se do të kthehen prapë.

Do të kthehen pasi të shkojnë te familjet e tyre dhe do t’i hapin ngarkesat e mallit të tyre.

Vëllezër të nderuar!

Vëllezërit e Jusufit a.s. janë kthyer me plot ushqim në shtëpitë e tyre.

Ata ishin të gëzuar, po ashtu edhe Jakubi a.s. është gëzuar.

Gjatë bisedës vëllezërit e Jusufit i tregojnë se çka ju ka ndodhur atyre.

Si janë pritur me nderime.

Si janë respektuar nga Azizi i Egjiptit kur kanë blerë grurë.

I tregojnë babës së tyre për atë mbret, se çfarë njeriu i mirë ishte, sa i bukur, sa i drejtë dhe i ndershëm,

Pastaj thonë: Shiko na ka kthyer edhe mjetet e pagesës së ushqimit/

Dihet se,

Zakonisht, njeriu gëzohet kur merr diçka falas.

Me kthimin e mjeteve financiare paralelisht me mallin e blerë, shihet qartë se është joshje për t'u kthyer edhe njëherë dhe për të realizuar qëllimin madhështorë, e ai qëllim ka qenë që Jusufi të bashkohet me gjithë familjen e tij, me babën e tij me tezen e tij dhe me vëllezërit e tij.

Kjo është metodë efektive, vepër e mirë, për të bërë përgatitje për t'i pritur me nderimet më të larta, dhe me përshëndetje lamtumirëse të paharruar, për vëllezërit e mëdhenj të Jusufit, të cilët i kishin bërë keq kur e kishin hedhur në pus.

Të keqen e ka kthyer me të mirë. Kjo është vlerë e peygamberëve, të ndriturve dhe dashamirëve fisnik.

Vëllezër të nderuar!

Djemtë e Jakubit i thonë babës së tyre:

Lejo që edhe Benjamini të vijë me ne në Egjipt.

Ne prapë do të sjellim ushqim për familjen.

Do ta ruajmë vëllanë tonë Benjaminin.

Do ta sigurojmë dhe do të përkujdesemi për të.

Për këtë mos u brengos, për shkak të tij do të furnizohemi edhe më shumë me produkte ushqimore.

Ajo ngarkesë shtesë, është çështje e lehtë për atë udhëheqës bujarë, dhe do të jetë edhe më i mëshirshëm nëse e marrim vëllanë tonë me vete.

Në fund i kanë thënë: “O babai ynë, qeveritari i Egjiptit na ka ndaluar që në të ardhmen të furnizohemi me ushqim nëse nuk shkojmë me vëllanë tonë Benjaminin.”

Le të vjen me ne vëllai jonë, që të fitojmë të drejtën të furnizohemi me ushqim në masë të numrit tonë, ne do ta ruajmë nga çdo e keqe, dhe nga çdo e padëshiruar edhe gjatë vajtjes edhe gjatë ardhjes.

Mos u brengos për të: “Me dëshirën e Allahut do të kthehet, vetëm e vetëm sa t’ia plotësojmë kushtin Azizit, i cili na ka nderuar”.

Duke kërkuar besën nga fëmijët e Tij, Jakubi thotë:” A ju kujtohet në të kaluarën çështja e Jusufit?”

Jakubi a.s kur sheh se është në interes të përgjithshëm, duke u nda nga Benjamini thotë: Po si mund të ju besoj juve, kur e dini se si keni vepruar me Jusufin, pasi më keni pas dhënë premtimin dhe më keni pas siguruar se do ta ruani atë, mirëpo, unë me pak shpresë po e dorëzoj çështjen te Allahu , Zotit im, dhe i besoj Atij, mbështetem te Ai,

Zoti im është më i mëshirshmi për mua, do të ketë parasysh të zbret mëshirën e Tij mbi pleqërinë dhe dobësinë time dhe atë që ka të bëjë me fëmijët e mi.

E lus Allahun që të më mëshiron duke i mbrojtur ata, dhe që t’i kthejë tek unë dhe të mblidhen forcat.

Ky është dorëzimi dhe mbështetja e Jakubit a.s.

Ky është qëndrimi i pejgamberëve i cili buron nga besimi i thellë, dhe bindjes ndaj Zotit të gjithë botëve. Këtë qëndrim e mbajnë edhe besimtarët.

Këtë qëndrim mbajeni edhe ju besimtarë të nderuar!.

Nuk e lejoj Benjaminin që të vjen me ju derisa të mos përбетoheni se, në çfarëdo rasti ju do të ktheheni me të, vetëm në rast që pengoheni që të gjithë, ashtu që vdisni, ose që të gjithë dështoni ose që të gjithë humbni, dhe nuk mund të gjeni zgjidhje”.

Vëllezër të nderuar!

Pasi kanë shkuar, janë përбетuar, Jakubi ka thënë:

“Allahu është dëshmitarë për të gjithë ne, pra monitoron dhe e zbulon çështjen e fshehtë.

Çështjen e dorëzoj te Allahu”.

Jakubi a.s., kësaj radhe u ka besuar dhe ka dëshmuar te Allahu.

I ka porositë fëmijët që t’i mbështeten Allahut.

عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ

“Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t’i mbështeten ata që besuan.” (Jusuf: 67)

I ka paralajmëruar që t’i mbështeten Allahut, mirëpo ai mbështetjen e ka bërë paralelisht duke i pasuar shkaqet, duke kryer obligimin dhe duke u angazhuar brenda kornizës së aftësive njerëzore.

Ky, edhe është qëllim i mbështetjes së vërtetë në Allahun, dhe fundi i çështjes dhe përfundimi pas angazhimit, dhe pas veprimit se te Allahu arrihet suksesi.

Rezultatet marrin formë në bazë të urtësisë së Allahut, dhe dëshirës së drejtë të Tij.

Djemtë e Jakubit kur janë përshëndetur me babën, Jakubi ju ka thënë: Përcilljani përshëndetjet e mia mbretit të Egjiptit dhe thojini: “Baba ynë lutet për ty dhe të falënderon për mirësinë tënde.” ka pasur për qëllim: “lutjen për të arritur grada të larta te Zoti, mirësi dhe falje prej Tij.”

Vëllezër të nderuar!

Dredhia legjitime.

Biografia dhe porositë e pejgamberëve janë shembull i mirë në jetën praktike.

Pejgamberët gjithmonë veprojnë:

- ose nga inspirimi i Allahut të Madhërishëm

- ose nga shpallja e Allahut të Madhërishëm.

Komunikimet e pejgamberëve janë thirrje prej Allahut.

Udhëzimet e pejgamberëve janë ligje prej Allahut.

Komunikimet e pejgamberëve janë për të mirën dhe për lumturinë e njeriut, për të arritur sukses dhe dobi, qoftë edhe për një kohë të gjatë.

Udhëzimet pejgamberike janë për të mbrojtur njeriun nga llojet e ndryshme të dredhive dhe të këqijave, për t'u siguruar që të mos rrëshqitet në ndonjë greminë apo humnerë.

Kjo mënyrë e këshillave është e mirë.

Kjo është mënyra e këshillave të Jakubit për fëmijët e tij, e ajo është: hyrja nga dyert e ndryshme, ashtu që të shihet nga secili administrator i Egjiptit se çfarë pritje bën dhe në çfarë mënyre përkujdesen, ose, edhe të mos ju bënë zili ndonjë prej ziliqarëve, kur të bien në sy, dhe ngazëllohen me numrin e madh të vëllezërve dhe të burrave.

Allahu i Madhërishëm tregon se Jakubi u ka thënë bijve të vet:

وَقَالَ يَا بَنِيَّ لَا تَدْخُلُوا مِن بَابٍ وَاحِدٍ وَادْخُلُوا مِنْ أَبْوَابٍ مُّتَفَرِّقَةٍ ۖ وَمَا أُغْنِي عَنْكُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ۚ إِنِ الْحُكْمُ لِلَّهِ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ ﴿٦٧﴾

“Po ai (Jakubi) tha: “O bijtë e mi, mos hyni (në Egjipt) për një derë, po hyni nëpër dyer të ndryshme. Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i All-llahut, vendimi nuk është i tjetërkujt vetëm i All-llahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t'i mbështeten ata që besuan.” (Jusuf: 67)

Përfundim

Jusufi a.s. kishte kërkuar nga vëllezërit që ta sillnin Benjaminin që të mbetej te ai si parapërgatitje për ta mbledhur familjen dhe për të jetuar me Jakubin a.s. i cili e kishte zemrën e pikëlluar për humbjen e Jusufit, pastaj, e njëjta i ndodhë edhe me Benjaminin.

Kjo provë, ndoshta ka qenë edhe më e vështirë për Jakubin a.s, sepse Benjaminin ishte shoqëruesi, i dashuri, ishte më i dhembshuri nga fëmijët, mirëpo,

Kjo provë ka ndodhur që të realizohet qëllimi i Zotit, caktimi i Tij.

Kjo provë ka ndodhur që të realizohet urtësia e Tij, dhe që të përgatitet rruga e takimit të familjes së tij fisnike në Egjipt.

Ndodhin sprova për të mirën tënde të cilën mirësi nuk e di ti.

Shkuan vëllezërit në Egjipt me vëllanë e tyre Benjaminin.

Vepruan ashtu siç i kishte këshilluar babai i tyre.

Duhet t'i marrim në konsideratë shkaqet, ndërsa për të realizuar çështjen duhet dorëzuar te Allahu i Madhërishëm, me bindje të thellë në drejtësinë e Tij.

Jemi të urdhëruar, t'i marrim në konsideratë shkaqet, ndërsa për të qenë të suksesshëm në çështje duhet pasur bindje të thellë në mirësinë e Tij, mëshirën e Tij dhe bamirësinë e Tij.

Duke i mbështetur çështjet te Allahu Famëlartë arrihen sukseset.

Duke e lënë në dëshirën e Allahut të Madhërishëm realizohen qëllimet.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe të tokës Ti je ndihmëtari ynë,

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë na bëj që të vdesim musliman, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja jote!

Zoti ynë na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E DHJETË

TAKIMI I JUSUFIT DHE BENJAMINIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit. Përshëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri. Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për agëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore që të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne me të shpallur të këtij Kur'ani po të rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”** (Jusuf, 3).

Dhe përfundon surja Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** (Jusuf, 111).

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Plani realizohet me dredhinë që e bëri Jusufi a.s. Jusufi e planifikoi çështjen që të pafajshmin ta akuzojë për vjedhje, e që ata të brengosen për Jakubin a.s., pasi që e kishte kuptuar se ishin përmirësuar, në të njëjtën

kohë për të rregulluar çështjet për të ardhmen, dhe me shpalljen e cila patjetër se duhet të realizohet, dhe me dëshirën e Allahut që t'i sprovtojë.

Kjo është ajo çka ka ndodhur në udhëtimin e dytë të djemve të Jakubit nga Palestina në Egjipt për t'u furnizuar me artikuj ushqimorë. Jusufi a.s. takohet me vëllanë e tij Benjaminin, vetmohet me të, ia tregon çështjen, ai e kupton se është vëllai i tij. Pastaj i thotë: Mos u brengos, mos ndiej keqardhje dhe mos u pikëlllo për atë që më ka ndodhur. E urdhëron që sekretin të mos ua tregojë vëllezërve të tij. U pajtuan që të mbetet me të i nderuar, i vlerësuar dhe i respektuar.

Këtë ngjarje e tregon Kur'ani:

وَلَمَّا دَخَلُوا عَلَى يُوسُفَ آوَىٰ إِلَيْهِ أَخَاهُ قَالَ إِنِّي أَنَا أَخُوكَ فَلَا تَبْتَئِسْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٦٩﴾

“E kur hynë te Jusufi, ai (Jusufi) e afroi pranë vetes vëllanë e vet (Benjaminin) dhe tha: ‘Unë jam vëllai yt, e ti mos u pikëlllo për atë që ata vepruan!’” (Jusuf: 69).

Sekretet mbani mes vëllezërve, mos ia shpalosni çdokujt.

Vëllezër të nderuar!

Jusufi ua përgatit ngarkesën, pra e përgatiti mënyrën e furnizimit me ushqim. Pasi i ngarkoi barrët me ushqim, u thotë disa prej shërbëtorëve që kupën prej argjendi ta vendosin nën ngarkesën e vëllait Benjamin, dhe që të mos e di askush.

Janë bërë gati për të shkuar. Kur janë bërë gati për të shkuar, një thirrës ka thirrur: “O pronarë të karvanit, ndaluni! Ju jeni hajdutë.”

Ata befasohen dhe poshtërohen. Pastaj shkojnë te thirrësi dhe i thonë: “Çka ju mungon?”

I përgjigjen: “Na mungon gota e mbretit me të cilën i peshojmë artikujt ushqimorë. Nëse ndonjëri nga pjesëtarët e ka gotën e mbretit në barrën e grurit, ai është përgjegjës.”

Pasi janë akuzuar për vjedhje, vëllezërit e Jusufit kanë thënë: “Për Zotin, ne ju kemi treguar herën e parë. E dini se ne nuk kemi ardhur për të shkaktuar trazira në tokën tuaj, e dini se ne nuk kemi ardhur për vjedhje, kurrë nuk kemi vjedhur. E dini se ne nuk shkelim të drejtën e asnjë njeriu. Familja jonë nuk e ka këtë veti.”

Shërbëtorët e Jusufit kanë thënë: “Nëse është në mesin tuaj, atëherë çfarë dënimi parashihet në qoftë se e gjejmë në mesin tuaj?! Çfarë dënimi

parashihet për vjedhësin nëse e konsideroni se jemi duke gënjyer kur po ju akuzojmë?!”

Ata përgjigjen: “Në bazë të ligjit tonë, ai i cili e ka marrë dhe gjendet në ngarkesën e tij, ai merret si kompensim. Kështu ne i dënojmë kriminelët të cilët vjedhin, kështu dënohen hajdutët.”

Kjo do të thotë se pronësohet hajni, ashtu siç e ka pronësuar sendin e vjedhur. Kjo dëshmon për ligjësimin e kësaj forme dhe për mënyrën e dënimit. Ky ligj është ligji i Ibrahimit dhe Jakubit a.s. Këtë e dëshironte Jusufi dhe ishte pjesë e zbatimit të planit të tij.

Fillojnë dhe i kontrollojnë ngarkesat e tyre para se të kontrollojnë ngarkesën e Benjamin, që të mos dyshohen. Pastaj e kontrollojnë dhe nxjerrin gotën nga ngarkesa e vëllait të tij Benjamin. Beniamini e pranon se ai e kishte marrë gotën dhe në bazë të ligjit të tyre duhej të merrej peng.

Kjo mënyrë e dredhisë, pra planifikimit të fshehtë, siç e ka planifikuar Jusufi në fshehtësi dhe si e ka inspiruar Allahu që të veprojë ashtu që ta merrte vëllanë e tij, është e ligjshme, pasi në bazë të saj realizohet interesi i mirë. Kjo llogaritet dredhi ligjore, nga e cila rezulton dobi në të ardhmen, por pa e dëmtuar askënd.

Po të mos ishte ky planifikim, Jusufi nuk do t’ia arrinte qëllimit për ta marrë vëllanë sipas sistemit ligjor të mbretit të Egjiptit, ku në bazë të ligjit të Egjiptit nuk zëvendësohej hajni me sendin e vjedhur. Jusufi e ka ditur ligjin e Jakubit. Në asnjë mënyrë nuk do të kishte mundësi në bazë të sistemit të mbretit, por vetëm në bazë të dëshirës së Allahut. Ai ka vepruar kështu me lejen dhe nga shpallja prej Allahut, gjë që tregon se ajo dredhi ligjore ka qenë e lejuar nga Allahu i Lartë dhe i Urtë. Zoti i Madhërishëm thotë: “Mbi çdo të ditur, ekziston një edhe më i ditur.”

Kjo nënkupton se: “Për nga dituria njerëzit janë kategori mbi kategori. Për çdo dijetar, patjetër se duhet të ketë më të ditur.” Përderisa vëllezërit e Jusufit kanë qenë dijetarë, atëherë Jusufi ka qenë më i ditur se ata.

Vëllezër të nderuar!

Kriza është ashpërsuar te bijtë e Jakubit në Egjipt dhe në mes tyre dhe babait të tyre në Palestinë. Ata kanë rënë në krizë të thellë dhe në greminën e pakapërcyeshme. Del në shesh natyrshmëria e tyre, edhe pse ata ishin të pafajshëm në rastin e ndodhjes së vjedhjes. Ngjarja ka ndikuar që ta humbin kontrollin krejtësisht. Kanë filluar me akuza të padrejta, kanë filluar të frikësohen nga takimi me babanë, kanë filluar të frikësohen nga dhembja dhe nga fatkeqësia e re, atëherë kur të ktheheshin te babai i tyre pa Benjaminin.

Si kanë vepruar në momentin kur janë akuzuar? Vëllezërit e Jusufit e kanë shprehur natyrshmërinë e tyre dhe mendimet e këqija të tyre karshi Jusufit. E akuzojnë se ai ka vjedhur kur ishte i vogël dhe se që të dy vëllezërit janë hajna. Kanë thënë: “Nëse Benjamini e ka vjedhur gotën, njësoj edhe vëllai i tij Jusufi ka vjedhur më herët, ata nga natyra e tyre janë të këqij.”

Jusufi nuk flet asgjë për ta, por vetëm është larguar prej tyre dhe në vetvete ka thënë: “Ju jeni në pozitë më të vështirë se ai të cilin e akuzoni për vjedhje, sepse ju e keni vjedhur vëllanë tuaj nga babai juaj dhe e keni hedhur në pus për ta shkatërruar dhe për t’u liruar prej tij. Allahu di se me çka ju kujtohet dhe çka pretendoni.”

Zoti i Madhërishëm thotë:

قَالُوا إِن يَسْرِقْ فَقَدْ سَرَقَ أَخٌ لَهُ مِنْ قَبْلُ

(Vëllezërit) Thanë: “Në pastë vjedhur ky, ka pasur vjedhur më parë një vëlla i tij.” (Jusuf: 77)

Jusufi këtë e mbajti fshehtë në vete, e nuk ua zbuloi atyre dhe tha:

فَأَسْرَهَا يُوسُفُ فِي نَفْسِهِ وَلَمْ يُبْدِهَا لَهُمْ قَالَ أَنْتُمْ شَرُّ مَكَانٍ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا تَصِفُونَ ﴿٧٧﴾

“Ju jeni në pozitë më të keqe (këtë e tha me vetvete e jo atyre), Allahu e di më mirë për atë që trilloni.” (Jusuf: 77)

Pastaj kanë kërkuar ndërmjetësim te Jusufi duke thënë: “O mbret, ai ka një babë plak, këtë djalë e do së tepërmi, në vend të tij ndale ndonjërin nga ne, ne e kemi vërejtur se je njeri i mirë, kur na ke nderuar dhe na ke furnizuar me ushqim.”

Jusufi thotë: “Zoti më mbrojtë dhe te Ai kthehem dhe pendohem, po ta ndaloja dikë tjetër te i cili nuk ka qenë gota, po të vepronim ashtu do të bëheshim kriminelë, sepse atëherë do ta dënonim të pafajshmin.”

Vëllezër të nderuar!

Kur vëllezërit e Jusufit i kanë humbur shpresat për ta liruar vëllanë e tyre Benjaminin, për të cilin i kishin premtuar babait të tyre se do t’ia kthejnë shëndoshë e mirë, ata janë larguar dhe kanë filluar të bisedonin në mes vete. Më i madhi i tyre, Simeoni, e jep një mendim me kujdes dhe me dituri, edhe pse ishte më i vjetri: “A nuk i keni premtuar babait se do t’ia ktheni Benjaminin? Më herët e keni tepruar me Jusufin. Unë kurrë nuk do ta lëshoj Egjiptin derisa të më jep leje babai im, ose derisa të më mundësojë Allahu që ta rikthej vëllanë tim Benjaminin. Kthehuni te babai juaj dhe thojini: ‘O ati ynë, djali yt vodhi, ne dëshmojmë vetëm për atë që dimë, e për të fshehtën ne nuk ishim roje!’ Allahu është vendimmarrësi më i mirë për drejtësi dhe për të vërtetën.”

Kthehuni te babai juaj dhe thojini: “O babai ynë, djali yt e ka vjedhur gotën e mbretit dhe e ka pronësuar Azizi i Egjiptit. Ne nuk dimë asgjë për vjedhjen, vetëm atë çka e kemi mësuar dhe e kemi kuptuar më vonë. Ne nuk e kemi ditur të fshehtën se ai mund të vjedhë, atëherë të kishim premtuar se do ta kthenim prapë. O babai ynë, nëse nuk na beson, atëherë pyeti banorët e atij vendi ku kemi qëndruar, pra, banorët e Egjiptit, pyeti edhe pjesëtarët e karvanit të cilët ishin me ne gjatë furnizimit me mallra ushqimorë. Ne jemi të sinqertë në atë që themi.”

U kthyen vëllezërit e pikëlluar në shtëpi, i thanë babait të tyre:

– O baba, djali yt ka vjedhur.

Ne e flasim të vërtetën, por ti prapë nuk po beson.

Por Benjamini në të vërtetë nuk kishte vjedhur.

Jakubi a.s. duroi e duroi, duroi më shumë se kurdoherë tjetër. Ishte i bindur se Zoti do ta shpërblente për durimin e tij, se Zoti do ta shpërblente për humbjen e djemve të tij, se Zoti do t’ia kthente të dy djemtë e humbur. Jakubi thotë: “Ju e keni zbukuruar një çështje tjetër të cilën e keni dëshiruar dhe keni bërë dredhi të re, por durimi është çështja më e mirë.”

Ai as nuk ka kritikuar dhe nuk i është ankuar askujt pos Allahut, se ndoshta Allahu do t’i kthejë të tre djemtë. Dhe ua ktheu shpinën e tha: “O

dëshpërim i imi për Jusufin!” dhe nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë, por i përmbajtur (nga pikëllimi).

Ata thanë: “Për Allahun, ti vazhdimisht e përkujton Jusufin derisa do të sëmuresh rëndë e do të shkatërroresh.”

Ai (Jakubi) tha: “Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut, e unë di për Allahun atë që ju nuk e dini.”

Vëllezër të nderuar!

Pikëllimi i Jakubit ka filluar të përsëritet me ngjarjen e Benjamin. Jakubi a.s. ka nofkën: “Personi i dy pikëllimeve.” Jakubi a.s. sprovohet me sprovë të re, kur e dërgon djalin tjetër, Benjaminin. Jakubi a.s. ka thënë: “Allahu e di më së miri gjendjen time. Ai është i urtë në përcaktimin e çështjeve. Ai është i urtë në veprimet e çështjeve.”

Ua kthen shpinën djemve dhe ka filluar të pikëllohet. Nga pikëllimi i është formuar një perde në thjerrëzën e syve të tij; për shkak të pikëllimit dhe dhembjes së madhe është verbëruar. Ai e fshihte mallëngjimin dhe dhembjen e tij, e ka fshehur mërzinë dhe brengën e tij.

Pastaj fëmijët i kanë thënë: “Për Zotin, a ende po e mendon Jusufin, e cila çështje po të lodh, po të shkakton dhembje dhe po të shkatërron, ose edhe do të vdesësh?”

Ai u thotë: “Unë nuk ankohem për veten time, pikëllimin tim ia parashtroj vetëm Allahut, dhe di nga Allahu atë që ju nuk e dini, pra shpresoj të gjitha të mirat dhe në të gjitha begatitë.”

Vëllezër të nderuar!

Jakubi a.s. i urdhëron bijtë për të shkuar në Egjipt: “Pyetni a ka ndonjë lajm për Jusufin dhe vëllanë e tij!” Jakubi u ka thënë bijve të tij: “O bijtë e mi, shkoni në Egjipt, dhe mësoni çështjen e Jusufit dhe vëllait të tij Benjamin, dhe kurrë mos e humbni shpresën se Allahu për tejkalimin e fatkeqësisë, sepse shpresën në Allahun e humbin pabesimtarët, të cilët e mohojnë fuqinë e Tij, urtësinë dhe mëshirën e Tij.”

Jakubi a.s. i urdhëron bijtë për të shkuar në Egjipt, nga kishin ardhur dhe ku i kishin lënë vëllezërit, Benjaminin dhe Rubejlin. Nga Siria shkuan në Egjipt. Kur hynë te Jusufi a.s., kanë dashur ta testojnë dhe të shprehin ndjenjat duke treguar gjendjen e keqe të tyre dhe vështirësinë e tyre, dhe se babai i tij mendonte se mbreti i Egjiptit mund të jetë Jusufi.

I thonë: “O mbret i drejtë dhe i mëshirshëm, familja jonë është në gjendje të rëndë, familja jonë është në krizë ekonomike, jemi të lodhur nga rruga e mundimshme. Çështja e Benjamin e ka mërzitur babanë tonë dhe të gjithë të tjerët. Kësaj radhe nuk kemi mjete të mjaftueshme për të paguar furnizimin me ushqim; nëse bëni tolerim, pranojeni këtë shumë të pamjaftueshme, nuk përfiton asgjë nga kjo shumë. Nëse keni ndonjë qëllim të mirë, pranojeni këtë kompensim me ushqimin që do të na jepni. Nëse shuma me dërhëmë nuk e mbulon sasinë e mallit, atëherë na plotëso furnizimin me ushqim siç ke vepruar më parë. Na ke mësuar me sjellje të mirë ndaj nesh, atëherë na furnizo me ushqim shtesë dhe na jep në formë lëmoshe. Allahu i do ata të cilët japin lëmoshë dhe i shpërblen për veprat e tyre.”

Pasi e treguan gjendjen e vështirë ekonomike, pasi e treguan gjendjen e vështirë të familjes dhe kërkuar mirëkuptim, Jusufi e çel zemrën e tij dhe i mëshiron për t’ju bërë të mundshme ta mësojnë të vërtetën dhe veprimet e turpshme të mëhershme: “A e dini se çka keni vepruar me Jusufin dhe me vëllanë e tij Benjaminin, kur i keni ndarë nga njëri-tjetri që në vegjëli? A ju kujtohet kur Jusufin e keni hedhur në pus dhe është kanosur me vdekje? A ju kujtohet kur keni vepruar me egërsi dhe me injorancë ndaj tij, duke filluar me mosrespektim ndaj prindërve, pastaj edhe ndërprerjen e lidhjeve farefisnore? Ky është mëkat injorance, ose padituri rinie, dhe veprim i pamenduar...”

Duke e kuptuar, duke e dëshmuar dhe duke e vërtetuar, i drejtohen dhe i thonë: “Me të vërtetë, ti je Jusufi!”

E kanë kuptuar në bazë të disa shenjave të veçanta të cilat i ka pasur në trup. Atëherë në shpejtësi përgjigjet:

“Unë jam Jusufi, të cilit i është bërë padrejtësi. Unë jam i paafti të cilit i ka ndihmuar Allahu. Allahu më ka mbrojtur dhe më ka mundësuar të arrij këtë pozitë të cilën po e shihni. Ky është Benjamini, nga i cili më keni ndarë. Edhe Benjaminit i është bërë padrejtësi sikurse mua; pastaj, me ndihmën e Allahut edhe ai është begatuar ashtu siç po e shihni. Allahu me mirësinë e Tij na ka bashkuar, pasi për shumë vite ishim të ndarë, dhe na ka graduar në këtë botë dhe në botën tjetër. Ai i cili i frikësohet Allahut, i cili nuk bën mëkate dhe duron në sprova me të cilat ballafaqohet, si p.sh. me hedhjen në pus, me burgosje, Allahu nuk ia humb meritat e punëve të mira në këtë botë dhe në botën tjetër.”

Kjo është dëshmi prej Allahut Famëlartë se Jusufi ishte prej të devotshmëve durimtarë dhe vepërmirë.

Përfundim

Duke dëshmuar të vërtetën dhe duke pranuar mirësinë e tij, vëllezërit përgjigjen:

“Për Zotin, Allahu të ka graduar më shumë se ne, të ka pajisur me dituri, urtësi dhe me edukatë, të ka pajisur me pasuri dhe me udhëheqje, të ka pajisur me peygamberi dhe me shpallje, edhe pse ne kemi gabuar në të drejtën tënde.”

Pas këtij arsytimi dhe pas këtij pendimi, duke paraqitur pranimfaljen, Jusufi thotë:

“Allahu ju faltë mëkatet dhe padrejtësitë tuaja. Ai është më i mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve, ndaj atyre të cilëve pendohen dhe kthehen te Ai me devotshmëri.”

Kjo mënyrë e faljes së mëkatit është mënyrë shembullore e faljes së mirë dhe fisnike.

Njëjtë ka vepruar peygamberi ynë me banorët e Mekës, kur e ka çliruar Mekën, duke dëshmuar me fjalët e Jusufit. Pasi është bërë lajmërimi se:

Kush hyn në Qabe është i sigurt.

Kush hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i sigurt.

Kush rri në shtëpinë e tij është i sigurt.

Pastaj Muhamedi a.s. i pyeti banorët e Mekës, të cilët e kishin dëbuar nga Meka: “Çka mendoni, si do të veproj me juve?”

Të gjithë iu përgjigjën: “Ti je fisnik, vepro si të duash.”

Muhamedi a.s. u tha: “Shkoni nëpër shtëpitë tuaja të sigurt, ju jeni të lirë.”

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Ti je ndihmëtar i ynë.

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E NJËMBËDHJETË

KËMISHAT E JUSUFIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për agëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore që të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne me të shpallur të këtij Kur'ani po të rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”** (Jusuf, 3).

Dhe përfundon surja Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** (Jusuf, 111).

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Në radhë është mrekullia e këmishës.

Këmisha e Jusufit a.s. është përmendur tri herë: në fillim të sures, në mes të sures dhe në fund të sures.

Jusufi u thotë vëllezërve të tij: “Me këtë këmishë, shkoni te babai juaj dhe vendoseni në fytirën e tij, do t’i kthehet shikimi, pasi është verbëruar nga pikëllimi i tepërt, dhe sillni këtu të gjithë familjen, burra, gra edhe fëmijë.”

Tre këmishat e Jusufit a.s.

Kur’ani përmend tri këmishat e Jusufit a.s.:

- Këmisha e pashqyer (e pagrisur);
- Këmisha e shqyer (e grisur);
- Këmisha me aromë.

Këmisha e parë tregon për fabrikim të lajmeve, dëshmime, etj.

Këmisha e dytë tregon për tentim të fshehjes së fakteve.

Këmisha e tretë tregon për aromën që sjell lajmi i mirë.

Vëllezër të nderuar!

Sa i përket këmishës së parë:

Këmisha e pashqyer, e cila ka qenë dëshmi se Jusufin a.s. nuk e ka ngrënë ujku. Vëllezërit e tij e sjellin si dëshmi dhe thonë se prej Jusufit ka mbetur vetëm kjo këmishë dhe se ata janë të pafajshëm, ndërsa në realitet ishte e kundërta; në fakt ajo këmishë, për shkak se ishte e pashqyer, ishte dëshmi e tradhtisë së tyre.

Kjo është dëshmi se fshehja e gjurmës zbulohet nga vetë ajo që është si dëshmi për ata (prokurorët, dëshmitarët e rrejshëm, etj.) të cilët i fshehin gjurmët me vetëdije.

Për këmishën e parë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَجَاءُوا عَلَى قَمِيصِهِ بِدَمٍ كَذِبٍ

“Dhe e sollën këmishën e tij (të Jusufit a.s.) të përgjakur, me gjak të rremë.” (Jusuf, 18).

Vëllezër të nderuar!

Sa i përket këmishës së dytë:

Këmisha e shqyer në trupin e Jusufit a.s. në shpinë ka qenë dëshmi në favor të tij.

Në bazë të asaj këmishe është vërtetuar se ai nuk ka vrapuar pas bashkëshortes së sundimtarit, por se ajo ka vrapuar pas tij.

Për këmishën e dytë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

قَالَ هِيَ رَأَوْتَنِي عَنْ نَفْسِي ۖ وَشَهِدَ شَاهِدٌ مِّنْ أَهْلِهَا إِن كَانَ قَمِيصُهُ قُدَّ مِنْ قُبُلٍ فَصَدَقَتْ وَهُوَ مِنَ

الكَاذِبِينَ ﴿٢٦﴾

“Një i afërt i saj tha: nëse këmisha e tij është e shqyer përpara, ajo thotë të vërtetën, kurse ai (Jusufi) gënjen; nëse këmisha e tij është e shqyer prapa, ajo gënjen, ndërsa ai (Jusufi) e thotë të vërtetën.” (Jusuf, 26).

Vëllezër të nderuar!

Sa i përket këmishës së tretë:

I dëmtuari i cili më në fund e gjen shpëtimin dhe gëzimin. Këmisha e lajmit përgëzues për prindin e Jusufit a.s., Jakubin a.s., si dëshmi se Jusufi a.s. është i gjallë dhe do t'i kthehet prindit të tij, madje po me këtë këmishë Jakubit a.s. i rikthehet shikimi.

Për këmishën e tretë, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَلَمَّا أَن جَاءَ الْبَشِيرُ أَلْقَاهُ عَلَى وَجْهِهِ فَارْتَدَّ بَصِيرًا ۚ قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لَّكُمْ إِنِّي أَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ

﴿٩٦﴾

“Kur erdhi sjellësi i lajmit të mirë dhe ia vuri këmishën në fytyrë, atij iu kthye shikimi.” (Jusuf, 96).

Ajo këmishë kishte qenë e trashëguar nga Ibrahim a.s., me të cilën e kishte veshur, pasi kishte dalë nga zjarri.

اذْهَبُوا بِقَمِيصِي هَذَا فَالْقُوهُ عَلَى وَجْهِ أَبِي يَأْتِ بَصِيرًا وَأْتُونِي بِأَهْلِكُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٩٣﴾

“Ju shkon me këtë këmishën time, dhe hidhjani atë babit tim në fytyrë, e atij do t'i kthehet shikimi, e pastaj ejani te unë me tërë familjen time.” (Jusuf: 93).

Vëllezër të nderuar!

Plani i Jusufit, që në mënyrë graduale t'i afronte vëllezërit dhe familjen e tij, rezultoi të jetë i suksesshëm.

Ai planifikim ishte nga udhëzimet dhe mësimi i Allahut.

Planifikimi dhe programi, në njërën anë ishte i lehtë për t'u realizuar, për shkak se ishte i detajuar në mënyrë të përpiktë, dhe në anën tjetër për shkak të padituriës, tejkallimit të kufijve dhe komplotit të mëhershëm për Jusufin.

Vëllezërit e Jusufit a.s. nuk kanë kuptuar asgjë nga ai planifikim, vetëm atëherë kur ka ndodhur udhëtimi i tretë nga Palestina për Egjipt.

Ju ka ardhur si befasi atëherë kur Jusufi u ka treguar për veten e tij se ai është Jusufi.

Duke përshkruar këtë takim vëllazëror dhe njohjen e rrallë në histori, Allahu i Madhërishëm thotë:

Ai tha:

قَالَ لَا تَحْزَنْ عَلَيْكُمُ الْيَوْمَ يَغْفِرُ اللَّهُ لَكُمْ وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ﴿٩٢﴾

“Sot nuk ka qortim kundër jush, Allahu ju faltë juve; Ai është mëshiruesi i mëshiruesve!” (Jusuf: 92).

Vëllezër të nderuar!

Pejgamberët dallojnë nga gjendja e rëndomtë dhe me veprime të cilat për njeriun janë jashtë normales.

Te pejgamberët ndodhin vepra jo të natyrshme, të cilat quhen mrekulli mbinatyrore.

Këmisha e Jusufit është prej mrekullive të veçanta në historinë e pejgamberëve.

Ka qenë befasues lajmi i Jakubit kur thoshte se e ndien aromën e djalit të pagjetur pas një periudhe të gjatë kohore, pra aromën e Jusufit.

Me një fjalë, është përputhur ideja e Jusufit dhe e babait të tij Jakubit.

Është kurorëzuar me gëzim çështja e Jusufit a.s., se ai ende është i gjallë dhe se ka arritur pozitë të lartë mbretërore.

Gëzimi e ka përfshirë edhe tokën e Egjiptit edhe të Palestinës.

Lajmëtari përgëzues i këtij rasti ishte djali më i madh i Jakubit.

Ai ishte Jehudha, i cili ishte ndalur në Egjipt.

Ai ishte i cili kishte shkuar me gjak të rremë.

Vëllezër të nderuar!

Jakubi a.s. e ka ndier aromën e djalit të dashur, pra aromën e Jusufit.

Allahu e ka mbjellë ndjenjën dhe aromën në shqisat e tij.

E ka ndier aromën e Jusufit atëherë kur ka arritur te ai djali më i madh i tij, Jehudha, nga largësia prej tri deri në tetë ditë.

E ka ndier aromën e Jusufit atëherë kur aromën e ka bartur era e mëngjesit.

E ka ndier erën e Jusufit atëherë kur devetë dhe fëmijët kanë dalë nga Egjipti dhe janë larguar nga qyteti.

Jakubi, i cili ishte peygamber i drejtë, i thotë familjes: “Unë po e ndiej aromën e Jusufit dhe të këmishës së tij, ju betohem e mos thoni që këtë e kam prej pleqërisë dhe prej mallëngjimit.”

“Kur ka dalë karvani nga Egjipti, aroma është shpërndarë dhe ajo aromë e këmishës ka shkuar deri te Jakubi, i cili ka thënë: ‘Unë po e ndiej aromën e Jusufit, po që se ju nuk më ofendoni.’”

E ka ndier aromën e tij në distancë prej tetë ditë udhëtimi.

Ajo aromë ka arritur tek ai nëpërmjet rrugës së mrekullisë mbinatyrore, sepse bartja e aromës prej asaj distance është në kundërshtim me ligjet e fizikës, kështu që më e përafërt dhe më e saktë është që të thuhet se është mrekulli mbinatyrore e Jakubit a.s.

Me fuqinë e Allahut dhe me dëshirën e Tij ua mundëson peygamberëve të Tij çështjet e pamundura.

Me përcaktimin e Tij dhe me dëshirën e Tij ua mundëson peygamberëve të Tij mrekullitë nëpërmjet tyre.

Vëllezër të nderuar!

Në tubimin ku ishte Jakubi, i thonë: “Për Zotin, ti je në humbjen tënde të vjetër, pra gabimi i vjetër është duke u përsëritur te ti, kur mendoje se Jusufi është i gjallë. Për Zotin, ti je në humbjen tënde të vjetër kur mendoje se ai nuk ka vdekur, se ai jeton dhe shpresoj se do të takohemi.”

Kur arrin përgëzuesi, e ai ishte Jehudha, i cili e kishte këmishën e Jusufit, i cili ishte i gëzuar dhe lajmëtar për vëllanë e tij dhe Benjaminin, e vendos në fytyrën e Jakubit, atëherë menjëherë i kthehet shikimi nga gëzimi i madh.

Kjo është mrekullia e radhës.

Atëherë, atyre që ishin prezentë, Jakubi u thotë:

“O bijtë e mi, a nuk ju kam thënë: Unë di çështje nga Allahu të cilat nuk i dini ju?

O bijtë e mi, kur keni shkuar në Egjipt, a nuk ju kam thënë: Hulumtoni për Jusufin dhe mos e humbni shpresën te Allahu?

O bijtë e mi, kur keni shkuar në Egjipt, a nuk ju kam thënë se e di saktësisht dhe me bindje të plotë se Allahu do të ma kthejë Jusufin?”

Kur e ka thënë këtë, djemtë, duke kërkuar falje dhe me butësi thonë: “Na fal mëkatet tona”, pra kërko nga Allahu që të na falë mëkatet tona, dhe se ne kemi bërë gabime dhe mëkate.

Ne kërkojmë falje dhe pendohemi për veprimet tona me vëllezërit tanë: Jusufin dhe Benjaminin.

Përfundim

Jusufi a.s. ua ka falur mëkatin vëllezërve të tij, po ashtu janë falur edhe nga babai i tyre.

I kanë thënë njëri-tjetrit: “Vetëm kjo nuk mjafton nëse nuk na fal Allahu.” Atëherë kanë kërkuar nga Jakubi që të kërkojë nga Allahu që Ai t'i falë ata, dhe e kanë pranuar gabimin.

Jakubi u ka thënë atyre: “Zoti im do t'ju falë juve”, pra në një të ardhme të afërt, në kohën e mbrëmjes, në pjesën e fundit të natës.

Kjo nga shkakut se Zoti im është falës i gabimeve dhe është i mëshirshëm ndaj robërve të Tij.

Kjo kohë është pjesa e kohës së fundit të natës, koha në të cilën pranohen lutjet.

Kjo, duke u bazuar në thënien e Allahut të Madhërishëm:

وَالْمُسْتَغْفِرِينَ بِالْأَسْحَارِ ﴿١٧﴾

“Dhe ata të cilët kërkojnë falje në pjesën e fundit të natës.” (Ali Imran, 17).

Pejgamberi a.s. ka thënë: ***“Zoti ynë zbret në çdo natë, kur është pjesa e tretë e natës, në qiellin e kësaj bote dhe thotë: ‘Kush më lutet Mua, i përgjigjem; kush kërkon falje, ia fal.’”***

Pejgamberi a.s. ka thënë: ***“Jakubi e ka vonuar kërkimfaljen deri në natën e xhuma.”***

Jakubi a.s. ka vonuar deri në pjesën e fundit të natës së xhumasë.

Ka qenë edhe nata e xhumasë, edhe nata e ashurasë.

Zoti ynë, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Ti je ndihmëtari ynë!

Zoti ynë, Ti kujdesesh për çështjet tona në këtë botë dhe në botën tjetër!

Zoti ynë, bëna që të vdesim muslimanë, të nënshtruar dhe të dorëzuar te çështja Jote!

Zoti ynë, na përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve tanë!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

HUTBEJA E DYMBËDHJETË

PËRFUNDIMI I MIRË I FAMILJES SË JAKUBIT

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet ushqim të mendjes dhe shpirtit.

Përsëndetjet dhe selamet qofshin për Pejgamberin a.s., për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Gjykimit.

Mendja dhe shpirti ushqehen siç ushqehen trupat, mbushen siç mbushen trupat, forcohen siç forcohet hekuri.

Mendjet mbushen siç mbushen trupat, kërkon ushqimin e mendjes në urtësi.

Tregimet janë ushtri prej ushtrive të Allahut të Madhërishëm. Allahu me këto tregime forcon zemrat e besimtarëve.

Tregimet kur'anore nuk janë tregime për agëtim dhe për zbavitje. Nuk janë për humbje kohe, por për mësim dhe përfitime. Duhet t'i lexojmë tregimet kur'anore që të përfitojmë dhe të veprojmë. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Të gjitha këto që t'i tregojmë ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde.”

Duhet të kuptojmë se historitë e Kur'anit janë mësim dhe këshilla për të logjikshmit, nuk janë proverba të trilluara. Në ajetet e para të sures Jusuf, Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne me të shpallur të këtij Kur'ani po të rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të painformuarit”** (Jusuf, 3).

Dhe përfundon surja Jusuf me ajetin: **“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.”** (Jusuf, 111).

Në këtë histori shohim suksesin dhe shpëtimin e besimtarëve dhe shkatërrimin e pabesimtarëve, e cila është mësim dhe këshillë për njerëzit me logjikë të shëndoshë dhe me ide të drejta.

Vëllezër të nderuar!

Historia e Jusufit me babanë dhe me vëllezërit e tij është histori interesante.

Historia e Jusufit me babanë dhe me vëllezërit e tij ka përfunduar në mënyrë interesante.

Temat dhe ngjarjet të cilat kanë ndodhur në një periudhë të gjatë kohore kanë ndodhur për t'i mësuar dhe për t'i udhëzuar njerëzit në atë se:

Është e domosdoshme t'u besohet thënieve të pejgamberëve të cilët lajmërojnë për shpalljen e Allahut;

Duhet mbështetur patjetër në besimin në Allahun Famëlartë;

Duhet të durohet gjatë ndodhive të padëshiruara;

Çështjet duhet dorëzuar te Allahu i Madhërishëm;

Nuk duhet nxituar, nuk duhet qenë i ndikuar për kryerje hakmarrjeje;

Nuk duhet bërë gabime ose mëkate, ashtu siç ka ndodhur me vëllezërit e Jusufit.

Ngjarjet kanë përfunduar te qëllimi i dëshiruar, e qëllimi ka qenë bashkimi i familjes së Jakubit në Egjipt.

Ky bashkim ka qenë kurorëzim i interpretimit të ëndrrës së Jusufit, të cilën ëndërr e kishte ëndërruar më herët, duke i bërë sexhde atij njëmbëdhjetë yje, e ato ishin vëllezërit dhe familja e tij.

Duke sqaruar këtë interpretim dhe këtë bashkim (takim) madhështor, Allahu i Madhërishëm thotë:

فَلَمَّا دَخَلُوا عَلَى يُوسُفَ آوَىٰ إِلَيْهِ أَبْوِيهِ وَقَالَ ادْخُلُوا مِصْرَ إِن شَاءَ اللَّهُ آمِنِينَ ﴿٩٩﴾

“(E morën familjen dhe shkuan) e kur hynë te Jusufi, ai i afroi pranë vetes të dy prindërit e tij dhe tha: ‘Me dëshirën e Allahut hyni në Egjipt të sigurt!’” (Jusuf: 99).

Vëllezër të nderuar!

Tubimi i dymbëdhjetë vëllezërve është realizuar në shtëpinë dhe në mbretërinë e Jusufit, ku edhe e pranojnë mëkatën e tyre.

Jusufi ua fal gabimin e tyre, pastaj është rikthyer dashuria vëllazërore dhe është krijuar ambienti për t'i pritur babanë e tyre Jakubin a.s.

Jusufi a.s. kishte kërkuar që t'i sjellin të gjithë anëtarët e familjes te ai.

Familja ishte shpërngulur nga vendet e Kenanit të Palestinës për në Egjipt, për të jetuar aty.

Shkuan Jakubi, teza e tij, vëllezërit e Jusufit dhe familja e tij.

Kur kanë mbërritur në Egjipt, i ka takuar me udhëheqësit dhe me shoqërinë elitare të Egjiptit.

Kanë hyrë te Jusufi, në vendin e pozitës udhëheqëse.

Jusufi i përqafon prindërit, pra babanë dhe tezen e tij, sepse nëna e tij veç ka qenë e vdekur, e pastaj Jakubi është martuar me atë tezen e Jusufit, me fjalë të tjera me motrën e gruas.

Jusufi i thotë familjes në përgjithësi: "Hyni në Egjipt, me dëshirën e Allahut jeni të sigurt."

Vendosuni, jetoni dhe qëndroni në qytetin e Egjiptit me dëshirën e Allahut.

Jeni të sigurt dhe të garantuar në jetën tuaj, në pasurinë tuaj dhe në familjen tuaj; as mos u pikëlloni dhe as mos u frikoni.

Ata ishin shtatëdhjetë burra, një grua dhe një djalë.

Vëllezër të nderuar!

Për t'i respektuar, Jusufi e vendos shtrojën e mbretërisë që të ulen me të.

Njëmbëdhjetë vëllezërit dhe dy prindërit i bien në sexhde përshëndetjeje dhe respektimi, e jo sexhde adhurimi dhe shenjtërimi.

Sexhdeja e tyre ka qenë vetëm përulje e kokës poshtë, e cila ka qenë në atë kohë përshëndetje ndaj mbretërve dhe të mëdhenjve.

وَرَفَعَ أَبَوَيْهِ عَلَى الْعَرْشِ وَخَرُّوا لَهُ سُجَّدًا

“Dhe ai të dy prindërit e vet i mori lart në fron (i uli pranë vetes), e ata iu përulën atij.” (Jusuf: 100).

Pas asaj përshëndetjeje, Jusufi thotë:

وَقَالَ يَا أَبَتِ هَذَا تَأْوِيلُ رُؤْيَايَ مِنْ قَبْلُ

“O babai im, ky është realizimi i interpretimit të ëndrrës së mëparshme.” (Jusuf: 100).

Pra, kjo sexhde është interpretim i ëndrrës së mëparshme në vegjëli, e ajo ëndërr ka qenë:

إِذْ قَالَ يُوسُفُ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ إِنِّي رَأَيْتُ أَحَدَ عَشَرَ كَوْكَبًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ رَأَيْتُهُمْ لِي سَاجِدِينَ



“Unë kam ëndërruar se njëmbëdhjetë yje, dielli dhe hëna më bënin sexhde mua.” (Jusuf, 4).

Ëndrrat e peygamberëve janë të vërteta.

Ëndrrat e peygamberëve janë të drejta.

Ëndrrat e peygamberëve janë të realizueshme.

Është realizuar ëndrra e Ibrahimit duke e prerë djalin e tij Ismailin dhe është bërë shkak që t'i bëhet obligim që pastaj ta realizojë në të njëjtën mënyrë; kështu ka ndodhur me këtë ëndërr të Jusufit, e cila është bërë shkak që të bëhet obligim ajo sexhde, pra sexhde e përshëndetjes.

Pastaj,

Jusufi thotë: “Allahu më ka dhuruar mirësi, mua, më ka begatuar dhe më ka vlerësuar.”

Allahu më ka vlerësuar dhe më ka begatuar me të mirat e Tij:

- atëherë kur ka mundësuar lirim tim nga burg;
- atëherë kur më ka mundësuar të arrij pozitë të lartë shtetërore;
- atëherë kur u ka sjellë juve nga vendet e largëta dhe shkretinore;
- atëherë kur vendet në periferi kanë siguruar jetën me bagëti dhe bujqësi;
- atëherë kur u ka transferuar nga jeta e vështirë në jetë me mirësi, dhe nga jeta shkretinore në jetë të civilizimit dhe të qytetërimit, në jetë komode.

قَدْ جَعَلَهَا رَبِّي حَقًّا وَقَدْ أَحْسَنَ بِي إِذْ أَخْرَجَنِي مِنَ السِّجْنِ وَجَاءَ بِكُم مِّنَ الْبَدْوِ مِن
بَعْدِ أَنْ نَزَغَ الشَّيْطَانُ بَيْنِي وَبَيْنَ إِخْوَتِي

“Zoti im, këtë tanimë e bëri realitet, e mua më nxori prej burgut, e ju solli nga fshati pasi djalli pat futur përçarje ndërmjet meje dhe vëllezërve të mi.” (Jusuf: 100).

Vëllezër të nderuar!

Shikoni diplomacinë e Jusufit!

Shikoni urtësinë e Jusufit!

Jusufi nuk e ka përmendur ngjarjen e pusit. Kjo për t'i nderuar vëllezërit e tij dhe për ta siguruar jetën e tyre.

E ka menduar në vete se ajo ngjarje ka ndodhur vetëm atëherë kur ka ndërhyrë shejtani në mes tij dhe vëllezërve të tij, pra:

- e ka menduar se shejtani ka vepruar dhe e ka çrregulluar çështjen e tij;
- e ka menduar se shejtani e ka përkeqësuar gjendjen e tij;
- e ka menduar në vete se shejtani i ka prishur raportet në mes tij dhe vëllezërve të tij.

E ka fajësuar shejtanin. Kjo për shkak se shejtani ka qenë shkaktar i çrregullimit.

Jusufi e ka përmendur vetëm një pjesë të ngjarjes, e ka përmendur vetëm njërën anë të medaljes për të mirën e vëllezërve të tij, ashtu që të sqarojë pozitën e mirë të tyre. Kjo për shkak se kur pas vështirësisë dhe fatkeqësisë rezulton një e mirë, ajo e mirë ka vlerë të madhe.

Sa i përket cytjes së shejtanit, ajo është çështje faktike, duke u bazuar në thënien e Pejgamberit a.s.: ***“Asnjëri nga ju të mos e drejtojë armën në drejtim të vëllait të tij, sepse ai nuk e di se ndoshta shejtani ia dështon dorën e tij (e mbyt) dhe pastaj bie në humnerë të xhehenemit.”***

Kjo i bie në dorën e tij dhe realizohet veprimi.

Pas fjalës “cytje” fshihet kuptimi i mashtrimit dhe tradhtisë, ashtu që fjalia e merr formën “ua zbukuron shejtani dhe e tradhton dora”.

Vëllezër të nderuar!

Pastaj Jusufi thotë:

إِنَّ رَبِّي لَطِيفٌ لِّمَا يَشَاءُ إِنَّهُ هُوَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ ﴿١٠٠﴾

“Zoti im me mjeshtri e butësi realizon dëshirën e Vet për çka do; vërtet Ai është i Dijshmi, i Urti.” (Jusuf, 100).

Nëse Allahu dëshiron diçka, e ndërlihdh me shkaqe, e përcakton dhe e lehtëson.

Allahu e di çka është në dobi të njerëzve.

Allahu është i Urtë në thëniet dhe veprimtarinë e Tij.

Allahu është i urtë në caktimet dhe përcaktimet, çka përzgjedh dhe çka dëshiron.

Përfundim

Historia e Jusufit përfundon me një përfundim mbresëlënës të cilin duhet ta kenë parasysh udhëheqësit.

Historia e Jusufit përfundon me një përfundim mbresëlënës të cilin duhet ta kenë parasysh qeveritarët.

Historia e Jusufit përfundon me një përfundim mbresëlënës të cilin duhet ta kenë parasysh funksionarët.

Allahu çështjen e Jusufit e ka ndërlidhur mes pushtetit, udhëheqjes dhe peygamberisë.

E ka begatuar me të mira të shumta, e ka transferuar nga pusi dhe burgu në pozitën më të lartë qeverisëse dhe të udhëheqjes në Egjipt, ndërsa ai e ka falënderuar Zotin e tij.

Allahu e përgëzon Peygamberin me fitore, duke i treguar se ky është ligj i përgjithmonshëm i Allahut; e ai ligj është: Ndihma e Allahut për peygamberët kur ata janë në kriza, në vështirësi dhe duhet pritur çlirim nga Zoti, dhe në krijimin e bindjes së peygamberëve se idhujtarët përgënjeshtrojnë, nuk besojnë dhe insistojnë në pabesimin e tyre.

Përfundimi është se ndihma e Zotit vjen befasisht.

Allahu e shpëton cilindo; Allahu e shpëton peygamberin dhe besimtarët, ndërsa dënimi i përfshin përgënjeshtresit pabesimtarë.

Askush nuk mund ta pengojë dënimin prej Allahut dhe ndëshkimin ndaj atyre të cilët kanë bërë krime, kanë mohuar Allahun dhe i kanë përgënjeshtruar peygamberët.

Allahu i Madhërishëm sqaron qëllimin e përgjithshëm nga historitë e Kur'anit Fisnik.

Sqaron qëllimin e përgjithshëm brenda historive të peygamberëve me popujt e tyre.

Zoti i Madhërishëm thotë:

حَتَّىٰ إِذَا اسْتَيْأَسَ الرُّسُلُ وَظَنُوا أَنَّهُمْ قَدْ كُذِّبُوا جَاءَهُمْ نَصْرُنَا فَنُجِّيَ مَنْ نَشَاءُ ۖ وَلَا يُرِدُ بَاسُنَا عَنِ الْقَوْمِ الْمُجْرِمِينَ ﴿١١٠﴾

“(Nuk dërguam tjetër vetëm burra e ndihma u vonua) derisa të dërguarit gati e humbnin shpresën (se do t’i besojë populli), dhe menduan se u përgënjeshtroan (pse ende nuk i kapi dënimi), e atëherë u erdhi atyre (të dërguarve) ndihma Jonë. Ne i shpëtuan ata që deshëm. E dënimi Ynë kundër popullit idhujtar nuk zmbrapset.” (Jusuf: 110).

Kur’ani i vërteton ato çka janë baza të shëndosha; në të njëjtën kohë edhe i plotëson dhe i siguron.

Kur’ani është udhëzues i botëve në rrugën e drejtë dhe stabile; në të njëjtën kohë është mëshirë e përgjithshme nga Allahu, Zoti i botëve, për besimtarët, edhe në këtë botë edhe në botën tjetër.

Zoti i Madhërishëm thotë:

لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِّأُولِي الْأَلْبَابِ ۚ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِن تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّلْقَوْمِ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١١١﴾

“Në tregimet e tyre pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur’ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf: 111).

Në fund Jusufi a.s. e bën lutjen gjithëpërfshirëse, me të cilën i është lutur Allahut që ta shpërblejë në botën tjetër, ashtu siç e ka shpërblyer në këtë botë, ku thotë:

“Zoti im, më ke graduar në pozitën udhëheqëse të Egjiptit, më ke mësuar interpretimin e ëndrrave dhe të çështjeve, dhe fshehtësitë e fjalëve të Tua.”

Pra, Zoti i Madhërishëm ka treguar lutjen e Jusufit a.s. si në vijim:

﴿رَبِّ قَدْ آتَيْتَنِي مِنَ الْمُلْكِ وَعَلَّمْتَنِي مَا تَأْوِيلُ الْأَحَادِيثِ ۚ فَاطِرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ أَنْتَ وَلِيِّي فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ۖ تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ﴾ ﴿١٠١﴾

“(Pasi iu plotësua dëshira, Jusufi tha:) Zoti im, Ti më ke dhënë mua pushtet, më mësove mua komentin e ëndrrave; o Krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestari im në dunja e në ahiret, më bëj të vdes musliman dhe më bashko me të mirët!” (Jusuf: 101).

Po e përfundojmë këtë cikël të hutbeve me lutjen:

Zoti im, Krijuesi i qiejve dhe të tokës,

Ti je ndihmëtari im,

Ti kujdesesh për çështjet e mia në këtë botë dhe në botën tjetër;

Zoti im, më bëj që të vdes musliman, i nënshtruar dhe i dorëzuar te çështja Jote;

Zoti im, më përcjell te të mirët prej prindërve dhe gjyshërve të mi, Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut dhe Jakubit!

Ti je i Mëshirshëm, Fisnik, Ti ke mundësi për gjithçka!

Përmbajtja:

TREGIMET E KUR'ANIT	3
ËNDRRA E JUSUFIT A.S.	12
KOMPLOTI I VËLLEZËRVE TË JUSUFIT	22
SHPËTIMI I JUSUFIT NGA SHKATËRRIMI PREJ BUNARIT	37
HISTORIA E JUSUFIT ME GRUAN E AZIZIT	46
HISTORIA E JUSUFIT ME SHOKËT E TIJ NË BURG	60
INTERPRETIMI I ËNDRRËS SË MBRETIT	68
JUSUFI MINISTËR I FINANCIVE	76
FËMIJËT E JAKUBIT SHKOJNË NË EGJIPT	82
TAKIMI I JUSUFIT DHE BENJAMINIT	92
KËMISHAT E JUSUFIT	101
PËRFUNDIMI I MIRË I FAMILJES SË JAKUBIT	119